


nr. 4, prill 2009

gap

monitor


i vendimeve të Qeverisë së Kosovës



Vetëm pas kritikave të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar,  
Qeveria ndërron anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike

- Projektligji për Qeverinë pëson ndryshime rrënjësore
- Miratohen Ligjet për Shërbimin Civil dhe Pagat e Nëpunësve Civilë
- Merren masa kundër "Gripit të Derrave"
- Sërish miratohet Strategjia Kundër Korrupsionit 2009-2011

## Tungjatjeta!



Muaji prill mund të konsiderohet si periudhë e frytshme për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në tri mbledhjet e mbajtura në këtë muaj, Qeveria ka marrë gjithsej 44 vendime, ndërsa në përgjithësi, pas katër muajve të parë të vitit 2009, janë mbajtur 14 mbledhje dhe janë marrë 94 vendime.

Çështja e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike ka qenë prioritet i këtij muaji, pasi Qeveria e Kosovës ka marrë tetë vendime për ndërrimin e tyre. Gjithashtu, janë miratuar edhe 10 projektligje, janë marrë tetë vendime për ndarje të mjeteve financiare, si dhe janë marrë pesë vendime për miratim të strategjive, planeve të veprimit, ose inicim të procedurave për nxjerrjen e tyre.


Gjatë këtij muaji është miratuar edhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012, e cila nuk parasheh një të ardhme më të mirë për zhvillimin ekonomik të vendit. Për pikat kryesore të KASH 2010-2012, ju ftojme të lexoni në vijim.

Për herë të parë në Kosovë është miratuar Projektligji për Shërbyesit Civilë, i cili ka qenë kërkesë e shumë sindikatave të punëtorëve. Përveç këtij projektligji të rëndësishëm, Qeveria e Kosovës, më në fund, ka miratuar edhe Projektligjin për Prishtinën. Mos-hyrja në fuqi e Ligjit për Prishtinën, deri më tash, kishte bllokuar shumë projekte në qeverisjen komunale të kryeqytetit.

Në fund, mund të lexoni për zbatimin e vendimeve të muajve janar, shkurt dhe mars, të vitit 2009.

## Përmbajtja

- |    |   |    |   |
|----|---|----|---|
| 3  | Pas kritikave të PCN, Qeveria ndërron anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike                            | 20 | 30.000 euro për ngritjen e shtatores së dëshmorit Adrian Krasniqi   |
| 4  | Qeveria i ndan buxhet Agjencionit për Inteligjencë  | 21 | Zgjerohet lista e personave që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë diplomatike                                     |
| 5  | Qeveria zhblokon Projektligjin për Prishtinën   | 21 | Miratohet Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm   |
| 6  | Miratohet KASH 2010-12, që nuk parasheh gjendje më të mirë ekonomike  | 22 | Ndryshohet Ligji për Pyjet  |
| 7  | Qeveria kërkon hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit                       | 23 | Strategjisë Legjislative 2009 i shtohet edhe Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës                          |
| 8  | Miratohet Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës   | 23 | Emërohen anëtarët e Komisionit për Përdorimin e Gjuhëve   |
| 10 | Pagat e nëpunësve civilë tash e tutje do të rregullohen me ligj   | 24 | 35.276 euro për festimin e Ditës së Turqve  |
| 12 | Qeveria ndryshon Ligjin për Skemën e Ndihmës Sociale  | 24 | Miratohet Udhëzimi Administrativ për Vulën Rrethore   |
| 13 | Projektligji për Qeverinë pëson ndryshime rrënjësore  | 25 | Miratohet Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011             |
| 14 | 36.830 euro për organizimin e "Bursës së Punësimit"   | 25 | 4.150 euro për shënimin e 10 vjetorit të masakrës serbe në Burgun e Dubravës  |
| 14 | Miratohet Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë                                | 26 | Qeveria ndau 4.265 € për shënimin e 27 prillit – Ditës së të Pagjeturve në Kosovë                                     |
| 15 | Formohet Grupi Punues për Hartimin e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë                | 26 | Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ushqim, kërkohet ndryshimi i Udhëzimit Administrativ 18/2005                         |
| 16 | Merren masa kundër "Gripit të Derrave"  | 27 | Qartësohen obligimet e KEK-ut ndaj Administratës Tatimore   |
| 16 | Sërish miratohet Strategjia Kundër Korrupsionit 2009-11   | 27 | Nuk janë arritur në tërësi objektivat e deritashme të Strategjisë së Energjisë 2005-15                                |
| 17 | Ndryshohet Ligji Kundër Korrupsionit  | 29 | Formohet Grupi Punues për Hartimin e Dokumentit Përmbajtjesor të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave |
| 18 | Ndryshohet Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit   | 29 | Inicohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit                 |
| 18 | Më në fund, zgjidhen anëtarët e Bordit të Trustit Pensional   | 30 | Zbatimi i vendimeve të janarit  |
| 19 | Rinia bëhet me ligj të vetin  | 31 | Zbatimi i vendimeve të shkurtit   |
| 19 | Qeveria ndan 7.000 euro për Familjen e Erion Fonijit, fëmijës që humbi jetën nga kafshimet e qenve endacakë | 32 | Zbatimi i vendimeve të marsit   |
| 20 | 39.736 euro për "Festivalin e Lirisë"   | 34 | Përmbledhje   |



## Pas kritikave të PCN, Qeveria ndërron anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike

Në dhjetor të vitit 2008, Qeveria e Kosovës mori 15 vendime që kishin të bënin me emërimin e anëtarëve të bordeve në 15 ndërmarrje publike. Emërimet u kontestuan nga opozita, mediat dhe shoqëria civile, të cilat vlerësuan se në bordet e ndërmarrjeve publike ishin vendosur njerëz partiakë dhe jo profesionistë. Mirëpo, përkundër kundërshtimeve, Qeveria nuk ndërmori asnjë hap që t'i ndryshojë vendimet e emërimeve të anëtarëve të bordeve. U desh intervenimi i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN), që Qeveria t'i ndryshonte

ato, duke treguar edhe një herë se ajo reagon vetëm pas presionit të organizmave ndërkombëtarë, por

ishin të pjesshme, prandaj nuk dalluan shumë nga vendimet e dhjetorit 2008.

Ndërrimet në bordet e 8 ndërmarrjeve publike janë bërë pas kritikave të PCN-së se në këto borde ishin emëruar anëtarë politikë dhe jo profesionalë

jo ndaj kërkesave dhe ankesave të opinionit vendas.

Më 23 prill 2009, Qeveria e Kosovës ndryshoi 8 nga 15 vendimet për bordet e ndërmarrjeve publike. Ndryshimet

Në vijim janë paraqitur në formë tabelore krahasimet e vendimeve të dhjetorit 2008 dhe prillit 2009, për emërimet e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike:

Ndërmarrja Publike	Anëtarët e Bordit sipas vendimeve të dhjetorit 2008	Anëtarët e Bordit sipas vendimeve të prillit 2009
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bekim Jashari – kryesues</li> <li>2. Bislim Zogaj</li> <li>3. <b>Sejdi Hoxha</b></li> <li>4. Hanefi Muharremi</li> <li>5. Besnik Krasniqi</li> <li>6. <b>Abdullah Hoxha</b></li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bekim Jashari – kryesues</li> <li>2. Bislim Zogaj</li> <li>3. Naser Canolli</li> <li>4. Hanefi Muharremi</li> <li>5. Besnik Krasniqi</li> <li>6. Fejzullah Krasniqi</li> </ol>
Kompania e Ujitjes "Drini i Bardhë"	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fadil Kabashi – kryesues</li> <li>2. <b>Remzi Ismajli</b></li> <li>3. Beqir Metaj</li> <li>4. Shkodran Gaxherri</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ali Sefaj – kryesues</li> <li>2. Fadil Kabashi</li> <li>3. Beqir Metaj</li> <li>4. Shkodran Gaxherri</li> </ol>

Ndërmarrja Publike	Anëtarët e Bordit sipas vendimeve të dhjetorit 2008	Anëtarët e Bordit sipas vendimeve të prillit 2009
Hekurudhat e Kosovës	1. Halim Peci – kryesues <b>2. Skender Sallauka</b> <b>3. Selam Jemiri</b> <b>4. Burim Krasniqi</b> <b>5. Fitim Shala</b> 6. Halil Kilaj	1. Sejdi Hoxha– kryesues 2. Halim Peci 3. Hysen Fazliu 4. Agron Thaçi 5. Fadil Krasniqi 6. Halil Kilaj
Hidrosistemi “Ibër-Lepenc”	1. Nazmi Zenelaj - kryesues 2. Xhelosh Vataj 3. Murat Meha 4. Ilmi Ahmeti <b>5. Veton Vula</b> 6. Bajram Mustafa	1. Nami Zenelaj – kryesues 2. Xhelosh Vataj 3. Murat Meha 4. Ilmi Ahmeti 5. Faton Gjyshinca 6. Bajram Mustafa
Kompania e Ujitjes “Radoniqi-Dukagjini”	1. Cenë Delija – kryesues 2. Avdullah Kryeziu <b>3. Leonard Shehu</b> <b>4. Muharrem Jupa</b>	1. Cenë Deliaj – kryesues 2. Avdullah Kryeziu 3. Ismet Neziri 4. Artan Neziri
Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini”	1. Shkëlzen Hyseni – kryesues 2. Rexhë Abazi 3. Elez Hajdaraj <b>4. Kolë Berisha</b>	1. Shkëlzen Hyseni – kryesues 2. Rexhë Abazi 3. Elez Hajdaraj 4. Gjëllosh Gojani
Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor”	<b>1. Sabit Bytyqi – kryesues</b> 2. Ilaz Bulaci 3. Drita Grazhda <b>4. Sylejman Gashi</b> 5. Sahit Ukaj 6. Bujar Hasani	1. Naser Bajraktari – kryesues 2. Duda Balji 3. Drita Grazhda 4. Galip Hoda 5. Sahit Ukaj 6. Bujar Hasani
Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniqi”	1. Ruzhdi Këpuska – kryesues 2. Agim Gjoshi 3. Hajdar Grezda <b>4. Ismet Neziraj</b>	1. Ruzhdi Këpuska – kryesues 2. Agim Gjoshi 3. Hajdar Grezda 4. Leonard Shehu

\*Emrat e theksuar janë të atyre që janë larguar nga ndërmarrjet publike, të cilët mund të konsiderohen si persona politikë, ose si joprofesionalë.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, e cila pasqyron qartë ndryshimet, është ndërruar vetëm kryetari i një bordi dhe disa nga anëtarët e

bordeve. Bordet e shtatë ndërmarrjeve publike-KEK,PTK,KOSTT,Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave, tri

Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica”, “Hidromorava” dhe “Prishtina”- kanë mbetur të paprekura prej dhjetorit të vitit të kaluar.

## Qeveria i ndan buxhet Agjencionit për Inteligjencë

Agjencioni Kosovar i Inteligjencës dhe Presidenti emëruan Bashkim (AKI), është themeluar me ligj Smakajn për Kryeshef të AKI-së. Nga

Buxheti është ndarë në shumën prej 1.170.900 euro, prej të cilave 500.000 euro do të shkojnë për paga dhe mëditje. Nuk është bërë e ditur paga e Kryeshefit të AKI-së dhe ende nuk është punësuar askush përveç Kryeshefit, i cili është emëruar nga Kryeministri dhe Presidenti, në shkurt të këtij viti

nga Kuvendi i Kosovës, me 21 maj 2008, i cili ka hyrë në fuqi me 16 qershor 2009. Me 4 shkurt 2009, Kryeministri

emërimi i tij, me 4 shkurt, e deri në prill, nuk është ndërmarrë asnjë hap për konsolidimin e mëtejshëm të AKI-së. Me 29 prill, Qeveria e Kosovës mori

vendimin 05/62, me të cilin miratoi buxhetin e AKI-së për vitin 2009. Në vendim nuk ceket shuma e mjeteve, mirëpo pas hulumtimit tonë kuptuam se AKI-së i është ndarë buxhet në vlerë prej 1.170.900 euro. Kjo shumë e mjeteve pritet të shpenzohet në këtë mënyrë: 500.000 euro janë destinuar të shpenzohen për paga dhe mëditje për 90 punëtorët që pritet të ketë ky agjencion; 234.000 euro për mallra dhe shërbime; 16.900 euro për komunal; 20.000 euro për subvencione dhe transfere; dhe 400.000 euro për shpenzime kapitale.

## Qeveria zhbllokon Projektligjin për Prishtinën

Ligji për Prishtinën ka qenë njëri ndër premtime të Isa Mustafës, Kryetarit aktual të Komunës së Prishtinës, gjatë fushatës së tij zgjedhore për këtë post. Drafti i Projektligjit për Prishtinën është përfunduar në pjesën e parë të vitit 2008, kur i është dërguar Qeverisë për miratim. Për më shumë se gjashtë muaj, ai është bllokuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, me arsyetimin se ka kosto të madhe financiare - rreth

Qyteti i Prishtinës është Kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Qyteti i Prishtinës, si entitet i veçantë hapësinor, urban, ekonomik, shoqëror dhe administrativ, i ndarë në distrikte administrative, ushtron kompetenca të posaçme në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Qyteti i Prishtinës gëzon nivel të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe mundëson një pjesëmarrje aktive të qytetarëve në çështjet lokale.

shtesë në lartësinë jo më pak se 4 për qind e grantit total të komunave për secilin vit fiskal. Kryetari i Qytetit të Prishtinës, për dallim nga kryetarët e komunave tjera të Kosovës, është edhe Kryesues i Kuvendit të Qytetit të Prishtinës dhe Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa. Kryetari i Qytetit të Prishtinës nuk është anëtar i Kuvendit të Qytetit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, por ka të drejtën e votës shtesë, në rast të numrit të njëjtë të votave “për”, ose “kundër” ndonjë propozimi të caktuar. Qyteti i Prishtinës do të ketë dy Nënkryetarë të Komunës, të emëruar sipas nenit 60.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Projektligji për Prishtinën legalizon decentralizimin e shërbimeve dhe pushtetit lokal në pesë distrikte administrative të Qytetit të Prishtinës. Gjithashtu, me këtë projektligj parashihet edhe krijimi i Zonës Metropolitane të Prishtinës

Risi tjetër që parashihet në këtë projektligj është edhe krijimi i Zonës Metropolitane të Prishtinës, e cila do të përbëhet nga komunat Podujevë, Lipjan, Obiliq, Fushë Kosovë dhe nga Qyteti i Prishtinës. Gjashtë muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi, këto komuna parashihet ta nënshkruajnë një marrëveshje partneriteti për krijimin e kësaj zone. Zona Metropolitane e Prishtinës do t'i ketë organet e krijuara, sipas marrëveshjes për bashkëpunim. Buxheti i Zonës Metropolitane të Prishtinës, në bazë të marrëveshjes me komunat përkatëse, do të marrë resurse të mjaftueshme nga buxhetet e tyre, përfshirë edhe buxhetin e Qytetit të Prishtinës.

8 milionë euro, ndërsa miratimi i tij nuk e ka aprovimin e FMN-së. Gjatë qeverisjes së tij me Komunën e Prishtinës, Isa Mustafa është ankuar se pa miratimin e Ligjit për Prishtinën e ka të pamundur t'i ndër marrë reformat në Komunë. Duke e prituri ligjin, Komuna e Prishtinës vetëm në fillim të vitit 2009 ka mundur ta miratojë Statutin e Komunës në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Krijimi i një statusi në veçantë nga komunat tjera dhe nxjerrja e Ligjit për Prishtinën parashihet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Territori i Qytetit ndahet në pesë distrikte administrative. Çdo distrikt administrativ do t'i ketë organet e tij – Bordin e Distriktit dhe Drejtorin Ekzekutiv të Distriktit. Bordi i Distriktit do të përbëhet nga 7 anëtarë, 4 prej të cilëve do të jenë deputetë të Kuvendit Komunal, kurse 3 tjerët do të zgjedhen nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, pas propozimit të Kryetarit. Drejtori Ekzekutiv dhe nëpunësit civilë të Distrikteve Administrative nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të Qytetit të Prishtinës. Komuna e Prishtinës krijon Institutin për Planifikim Urban, i cili merret ekskluzivisht me planifikimin hapësinor, urban dhe mbrojtjen mjedisore të Qytetit të Prishtinës. Qyteti të Prishtinës i jepet një grant

Projektligji për Prishtinën, i cili u miratua në prill 2009, është një projektligj i shkurtër, me gjithsej 10 nene. Në nenin 3, thuhet se

## Miratohet KASH 2010-12, që nuk parasheh gjendje më të mirë ekonomike për tri vjetët e ardhshme

Me 30 prill 2009, Qeveria e Kosovës miratoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012 (KASH), të cilën ia dërgoi Kuvendit të Kosovës për miratim.

Në këtë kornizë janë paraqitur katër objektiva madhore që synohen të arrihen gjatë tri vjetëve të ardhshme: 1. Rritja ekonomike, 2. Implementimi i zgjidhjes së statusit,

çdo vit në tregun e punës. Banka Botërore konsideron se rreth 40 për qind e popullsisë së Kosovës llogaritet e varfër, sipas kuptimit më të gjerë të këtij termi. Gjithnjë sipas KASH, sistemi i tashëm arsimor nuk është i aftë që ta pajisë këtë shtresë të re të popullsisë më aftësi konkurruese për një ekonomi moderne të tregut. Kosova ka një

shtesë të financimit, për të kërkuar ndihmë plotësuese buxhetore nga donatorët, ose për t'i shkurtuar shpenzimet. Në vitin 2008, inflacioni në Kosovë ka shënuar rritje deri në 9.4 për qind, por një gjë e tillë mund të ndodhë edhe në periudhën në vazhdim, pasi që Kosova është një ekonomi e hapur dhe çdo lëvizje e çmimeve në rajon ndikon edhe në lëvizjen e çmimeve në Kosovë.

Në tri vjetët e ardhshme parashihet të ketë deficit buxhetor, rritje vjetore prej vetëm 3.0-4.0 për qind; mosritje të pagave të shërbyesve civilë, madje as për 5 për qind; etj.

Furnizimi i rregullt me energji elektrike - është një nga qëllimet kryesore të Qeverisë. Kjo synohet të arrihet duke i privatizuar asetet ekzistuese të furnizimit dhe distribucionit të KEK-ut. Mirëpo, subvencionet për KEK-un nuk do të ndërpriten deri në vitin 2011. Për zbutjen e varfërisë, Qeveria e Kosovës është duke punuar në draftin e "Letrës së Bardhë" për politikën sociale, e cila adreson një spektër të gjerë opsionesh të politikave që duhet marrë në konsideratë. Parashihet se në tri vjetët e ardhshme, shpenzimet do të rriten më shumë se të hyrat, duke bërë që të kemi deficit të vazhdueshëm.

3. Qeverisja e mirë, 4. Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti ekonomik.

Për arrijten e këtyre objektivave të paraqitura në katër shtylla kryesore, është paraparë edhe definimi i nën-objektivave dhe i hapave konkretë.

Sa i përket rritjes ekonomike, Qeveria pranon se një rritje prej 3-4 për qind në vit është rritje jo e kënaqshme dhe duhen shumë vite të tjera që papunësia të zbutet, së paku të përgjysmohet. Papunësia momentale në Kosovë është 35-40 për qind, kurse 29.000 të rinj hyjnë

deficit tregtar prej 40 për qind, ndërsa 65 për qind e të gjitha të hyrave të buxhetit mbliidhen në kufi. Parashihet që importet e mallrave dhe shërbimeve do të vazhdojnë me ritmin e ngjashëm të rritjes sikurse në vitet e kaluara. Deri në fund të vitit 2012, deficitit tregtar parashihet të arrijë në 41.6 për qind të BPV, respektivisht në 2 miliardë euro. Gjatë viteve të ardhshme, Kosova do të jetë në pozitë të vështirë fiskale, gjë që kërkon aplikimin e politikave të reja për të gjetur burime

Buxheti	2010	2011	2012
Të hyrat	1.029 mil. €	1.081 mil. €	1.133 mil. €
Shpenzimet	1.111 mil. €	1.109 mil. €	1.133 mil. €

Gjatë secilit prej tri vjetëve në vijim, mesatarja vjetore e shpenzimeve kapitale do të jetë 440 milionë euro. Kjo do të sjellë një boshllëk të financimit në një shumë kumulative prej minus 300.5 milionë euro deri në vitin 2012. Sipas KASH, boshllëku do të ndodhë për arsye se FMN ka kërkuar që rezerva fiskale do të duhej të rritej në 9 për qind të Bruto Produktit Vendor (BPV). Si pasojë e kësaj, Kosova do ta rrisë Rezervën e Stabilizimit nga 50 milionë euro, sa është tash, në 200 milionë euro për vitet në vazhdim. Prapëseprapë, kjo rezervë do të jetë më e ulët se ajo

që është kërkuar nga FMN, sipas së cilës do të duhej të arrinte në 375 milionë euro në vitin 2010.

Gjithashtu, anëtarësimi i Kosovës në FMN dhe në Bankën Botërore do të kërkojë obligime të shtuara financiare. Brenda gjashtë muajve, nga dita e nënshkrimit të anëtarësimit, Kosova duhet të paguajë 154 milionë euro. Një aspekt tjetër rëndues për Buxhetin e Kosovës, në të ardhmen e afërt, do të jetë edhe rritja prej 10 për qind e pagave të shërbyesve civilë, e cila ka rënduar Buxhetin e Kosovës për 14.8 milionë euro gjatë vitit 2009. Një rritje tjetër e pagave prej 5 për qind, ashtu siç është paralajmëruar, do ta

rëndonte edhe më shumë Buxhetin e Kosovës. Hyrja në fuqi e "Letrës së Bardhë" do ta ngarkojë Buxhetin e Kosovës edhe për 50 milionë euro, pasi që në të parashihet indeksimi i skemave pensionale dhe të atyre të asistencës sociale për vlerë të inflacionit (20 milionë euro në vit), dhe shtimi i buxhetit të shëndetësisë për 30 milionë euro në vit. Hyrja në fuqi e Ligjit të Policisë do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës me 10 milionë euro shtesë. Gjithashtu, krijimi i 5+1 komunave të reja, siç parashihet me Pakon e Ahtisaarit, do ta rëndojë Buxhetin e vitit 2010 me 13.783.199 euro.

Për ta mbuluar këtë deficit

buxhetor, Qeveria e Kosovës shpreson në donacionet e huaja dhe në kreditë që mund t'i marrë Kosova pas anëtarësimit në FMN dhe në Bankën Botërore. Gjithashtu, Qeveria planifikon ta deklarojë dividendin e PTK-së, i cili

kap shumë prej 150 milionë euro. Mirëpo, nëse një gjë e tillë ndodh, kjo mund të paraqesë problem në likuiditet për bankat lokale, pasi që pjesa më e madhe e dividendit të PTK-së mbahet në bankat e Kosovës. Opsion tjetër mbetet

privatizimi i PTK-së, i cili mund t'i sjellë Buxhetit të Kosovës të hyra prej 500 milionë euro. Ndërsa, nga privatizimi eventual i njësisë së furnizimit dhe distribucionit të KEK-ut, Buxhetit mund t'i shtohen edhe 30-50 milionë euro.

Prezantimi tabelor i buxheteve për secilën agjenci buxhetore për tri vjetët e ardhshme:

Institucioni	2010	2011	2012	Totali
MTPT	112.882.804 €	114.717.374 €	117.060.308 €	344.660.486 €
MEM	2.278.226 €	2.149.457 €	2.080.568 €	6.608.251 €
Sektori i Ndërmarrjeve Publike	86.550.000 €	17.900.000 €	14.300.000 €	118.750.000 €
MBPZHR	14.777.191 €	18.829.741 €	19.309.741 €	52.916.673 €
MTI	9.259.575 €	9.986.847 €	11.379.545 €	30.625.967 €
MASHT dhe UP	56.923.929 €	61.081.806 €	63.650.743 €	181.656.478 €
MKRS	11.422.789 €	14.850.481 €	14.426.457 €	40.699.727 €
MD	20.387.428 €	20.828.114 €	21.271.717 €	62.487.260 €
Departamenti i Drejtësisë	873.845 €	908.441 €	953.527 €	2.735.814 €
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	13.702.976 €	13.752.088 €	14.463.917 €	41.918.981 €
MPB	70.921.104 €	73.857.881 €	75.349.828 €	220.128.814 €
MFSK	31.397.267 €	32.403.048 €	34.673.478 €	98.473.793 €
MPMS	164.679.700 €	169.242.443 €	172.221.379 €	506.143.522 €
MSH	70.854.197 €	73.460.486 €	74.767.268 €	219.081.951 €
MSHP	35.751.733 €	32.251.733 €	32.251.733 €	100.255.199 €
MPJ	24.932.252 €	29.078.359 €	23.969.918 €	77.980.529 €
MEF	87.487.082 €	89.565.467 €	90.435.416 €	267.487.965 €
Shërbimi Doganor i Kosovës	9.865.837 €	10.064.983 €	10.186.007 €	30.116.827 €
MAPL	8.575.355 €	8.562.381 €	8.348.940 €	25.486.676 €

## Qeveria kërkon hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit do hartohen nga një grup ekspertësh, i cili do të koordinohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ende nuk është formuar grupi punues për hartimin e kësaj strategjie. Zyrtarët e MPB-së

shprehen se finalizimi i kësaj strategjie mendohet të bëhet në periudhën mes korrikut dhe shtatorit 2009, ashtu siç parashihet edhe me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian.

Strategjia Kombëtare për Migracionin do të ketë si fokus parandalimin e migrimit ilegal, si

dhe në hapjen e rrugëve për migrim legal.

Ne numrat e ardhshëm të GAP Monitor do të ofrojmë më shumë informata nëse është formuar ose jo grupi punues për hartimin e strategjisë, kush është anëtar aty, si dhe kur do të prezantohet në Qeveri strategjia për miratim.

## Miratohet Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Në mbledhjen e 62-të të Qeverisë së Kosovës, është miratuar Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ky miratim ka qenë një nga kërkesat më të zëshmetë sindikatave të punëtorëve. Shërbimi Civil në Kosovë, deri më tash, ka qenë i rregulluar me aktet juridike të UNMIK-ut, si Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë, dhe Urdhëresa Administrative 2003/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Shërbimin Civil do të shfuqizohen aktet e UNMIK-ut dhe disa akte nënligjore të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë, në

punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Kategoritë e punonjësve që marrin pagë nga Buxheti i Kosovës, por nuk konsiderohen Shërbyes Civilë, janë: punonjësit e sistemit arsimor, punonjësit e institucioneve kulturore, punonjësit e sistemit shëndetësor, zyrtarët policorë, zyrtarët doganorë, zyrtarët korrektues dhe pjesëtarët e FSK-së.

Marrëdhënia e punës së këtyre kategorive të punonjësve që nuk përfshihen në Projektligjin për Shërbyesit Civil do të rregullohet me Ligj të Punës. Shërbyes civilë nuk konsiderohen ata që mbajnë pozita publike, të emëruarit politikë, të gjithë të punësuarit në kabinetet e funksionarëve publikë. Me hyrjen

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Shërbimin Civil, numri i punonjësve që do të klasifikohen si shërbyes civilë do të jetë 14.746. Momentalisht, shërbyes civilë konsiderohen 74.654 punonjës, pasi legjislacioni në fuqi i klasifikon si shërbyes civilë të gjithë ata që marrin paga nga Buxheti i Kosovës.

kategorinë e Shërbyesve Civilë përfshinte çdo person të punësuar në një organ të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Përjashtim nga kjo bënin vetëm anëtarët e Këshillit, personat e emëruar dhe pjesëtarët e TMK-së. Prej tash, Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përfshin vetëm punonjësit civilë të administratës së Kuvendit, Presidencës, Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore, si dhe administratat komunale. Gjithashtu, pjesë e Shërbimit Civil konsiderohet edhe personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit, ose i punësuar në MPJ; personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në FSK, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës; personeli i

në fuqi të Ligjit për Shërbimin Civil, 14.746 punonjës do të kenë statusin e shërbyesve civilë, përkundrejt 74.654 punonjës sa e kanë tash këtë status.

Largimi nga kategoria e shërbyesve civilë i punonjësve arsimorë, shëndetësorë, policëve, etj., ka qenë edhe kërkesë e vetë sindikalistëve të këtyre grupeve, pasi ata kanë kërkuar që marrëdhënia e tyre e punës të rregullohet ndryshe nga ajo e shërbyesve civilë.

Projektligji i ri është shumë më voluminoz dhe më përmbajtësor se rregullorja e UNMIK-ut 2001/36. Projektligji është i ndarë në 10 kapituj dhe ka 107 nene.

Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sjell shumë risi në rregullimin e kësaj fushe në Kosovë.

Në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës do të ekzistojnë dy kategori të pozitave: 1. Pozitat e nëpunësve civilë të karrierës, të

cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme; 2. Pozitat e nëpunësve civilë të jo-karrierës, të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet për zbatimin e projekteve të caktuara, dhe i zëvendësojnë përkohësisht nëpunësit e përhershëm civilë, në rast të mbingarkesave në punë.

Saipërkethierarkisënë Shërbimin Civil, të punësuarit do të ndahen në katër kategori: 1. Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, 2. Nëpunës civilë të nivelit drejtues, 3. Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues dhe profesional, 4. Nëpunës civilë të nivelit administrativ.

Pranimi në Shërbimin Civil të

punonjësit e MPB-së të cilët nga 1 korriku 2008 deri me 28 shkurt 2009 kanë punuar jashtë orarit, duke bërë 11 orë punë në ditë, përfshirë edhe nga 8 orë punë të shtunave. Ky plan i MPB-së për punë jashtë orarit pritet të rifillojë me 1 korrik 2009 dhe të vazhdojë deri me 31 dhjetor 2009, mirëpo nëse Ligji për Shërbimin Civil hyn në fuqi, atëherë 406 punonjësve të MPB-së nuk do t'u lejohet të punojnë punë jashtë orarit nga 23 orë në javë, respektivisht nga 93 orë në muaj, ngase kjo do të jetë e jashtëligjshme. Në mungesë të normave ligjore që e rregullojnë këtë çështje, punonjësit e MPB-së kanë punuar së paku 93 orë pune,

ut 2001/19 për degën e ekzekutivit të IPVQ-ve, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil dhe Urdhëresën Administrative 2003/02. Ka kohë që KELP nuk është funksional. Për problematikën që e ka përcjellë këtë institucion kemi shkruar në numrin e parë dhe të dytë të GAP Monitor.

Projektligji për Shërbimin Civil nuk e përmend askund punën e KELP-it, prandaj, rrjedhimisht, e shpërbën edhe zyrtarisht këtë institucion, pasi që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri - do të shfuqizohen aktet që kanë rregulluar deri në këtë kohë punën e KELP-it.

Me projektligjin e ri, Sekretarët e Ministrive, të cilët deri më tash janë quajtur Sekretarë të Përhershëm, tash e tuje do të quhen Sekretarë të Përgjithshëm. Sekretarët e Përgjithshëm nuk do të jenë të përhershëm, por do të emërohen në një mandat trevjeçar. Sekretarët e Përgjithshëm do të përzgjidhen nga një listë e nëpunësve civilë, të klasifikuar në pozita të larta drejtuese. Ministria përgjegjëse për administratë publike do ta formojë një Komision për vlerësimin e kriterëve. Komisioni do të përbëhet nga shtatë anëtarë: tre Sekretarë të Përgjithshëm, një profesor fakulteti nga fusha përkatëse, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Titullari i institucionit, i cili shpall vendin e

Hyrja në fuqi e këtij ligji do ta shpërbëjë Komisionin për Emërimë të Larta Publike (KELP), kurse në vend të tij do të formohet një komision që do të jetë më i politizuar se KELP, i cili do t'i përzgjedhë Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive.

Kosovës do të bëhet në bazë të konkursit. Konkursi mbështetet në testimin me shkrim, i cili përbën 50 për qind të vlerësimit, testimin me gojë, që përbën 30 për qind të vlerësimit, si dhe vlerësimin e përvojës në punë dhe kualifikimeve, që përbëjnë 20 për qind të pikëve të përgjithshme.

Pranimi në Shërbimin Civil bëhet në pozitën më të ulët të kategorisë përkatëse, që nënkupton se për pozitat e larta mund të konkurrojnë vetëm punonjësit që janë të punësuar në pozita më të ulëta brenda Shërbimit Civil. Orari i rregullt i nëpunësve civilë nuk duhet t'i tejkalohet 40 orë në javë. Grave shtatzëna, nënave me fëmijë deri në moshën trevjeçare, dhe nëpunësve civilë me aftësi të kufizuara, nuk u kërkohet të punojnë natën dhe më shumë se 40 orë në javë. Në raste të jashtëzakonshme, ose për shkak të rritjes së nivelit të punës, nëpunësit civil mund t'i kërkohet që të punojë jashtë orarit. Kjo punë nuk duhet t'i tejkalohet 4 orë në ditë, 20 orë në javë, ose 40 orë në muaj. Vlen të përmendet se, deri më tash, puna jashtë orarit nuk ka qenë e definuar qartë. Në numrin e kaluar të GAP Monitor, kemi raportuar për 406

jashtë orarit në muaj.

Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë pushimi vjetor me pagesë në kohëzgjatje minimale prej 18 ditë pune. Kohëzgjatja e pushimit vjetor do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës - për çdo dy vjet përvojë pune, pushimi vjetor rritet për një ditë pune. Moshë e pensionimit është 65 vjeç. Nëpunësi

Në memorandumet shpjeguese të projektligjeve që Qeveria ia dorëzon Kuvendit, edhe më tutje thuhet: "ligji nuk bie ndesh me kompetencat e rezervuara të PSSP-së"

civil, ose administrata, mund të bjerë vendim për pensionim të parakohshëm të nëpunësit civil. Pensionimi i parakohshëm mund të merret vetëm pas moshës 63 vjeçare, pra dy vjet para pensionimit të rregullt.

Një nga çështjet më kontestuese në projektligjin është emërimi në pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil - përzgjedhja e Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive. Deri më tash, këto emërimë janë bërë nga Komisioni për Emërimë të Larta Publike (KELP), puna e të cilit është definuar me Rregulloren e UNMIK-

libër të punës, pra Ministri, i cakton dy anëtarë të Komisionit. Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe i propozon Ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre kandidatët më të mirë. Pastaj, Ministria përgjegjëse për administratë publike ia dërgon listën e tre anëtarëve titullarit të institucionit, ku do të punojë Sekretari i Përgjithshëm, dhe ia rekomandon Qeverisë njërin nga kandidatët. Një procedurë e këtillë e përzgjedhjes së Sekretarëve

të Përgjithshëm të Ministrive lë hapësirë për përzgjedhje të personave politikë në postin më të lartë të Shërbimit Civil të çdo institucioni të administratës publike.

Gjithashtu, sipas projektligjit, Kryeministri ka të drejtë ta urdhërojë vlerësimin e performancës së të emëruarve në pozitë e larta publike, gjë që i vë të emëruarit në pozitë e larta publike nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Kryeministrit.

Në tërë projektligjin përdoret termi

“Ministria përkatëse për administratë publike”, që nënkupton se kjo është Ministria për Administratë Publike (ish-Ministria e Shërbimeve Publike, që nuk ekziston më me këtë emërtim).

Projektligji parasheh edhe nxjerrjen e shumë akteve nënligjore, të cilat do të miratohen brenda periudhës njëvjeçare, nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit. Hyrja e këtij ligji në fuqi nuk do ta rëndojë Buxhetin e Kosovës, ngase një punë

e tillë aktualisht është duke u kryer nga Ministria e Shërbimeve Publike. Në memorandum shpjegues që Qeveria ia ka bashkangjitur projektligjit, thuhet se Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nuk bie ndesh me kompetencat e rezervuara të PSSP-së. Ky deklaram jepet në një kohë kur Qeveria deklaron se PSSP nuk ka fare kompetenca në Kosovë dhe misioni i UNMIK-ut duhet të shuhet.

## Pagat e nëpunësve civilë tash e tutje do të rregullohen me ligj

Qeveria ka miratuar Projektligjin për Pagat e Nëpunësve Civilë. Deri më tash, kjo fushë ka qenë e rregulluar me akte nënligjore, siç është Doracaku për Sistemin e Pagave dhe të Gradimit (i miratuar nga Qeveria e Kosovës, me vendimin 04/98 të 28 majit 2004), dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Shërbimeve Publike 2004/11 për Caktimin e Nivelit të Gradave në Shërbimin Civil.

Sipas Projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, paga e tyre

përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë. Paga bazë shpreh vlerën e pozicionit të punës

Me qëllim të përcaktimit të pagës bazë, pozitë në shërbimin civil ndahen në katër kategori funksionale

Momentalisht ekzistojnë akte të ndryshme ligjore që rregullojnë pagat e punonjësve të KEK-ut, PTK-së, shëndetësisë, arsimit, etj. Projektligji për pagat e nëpunësve civilë do t'i rregullojë pagat vetëm për ata që punojnë në administratën shtetërore

në raport me tërësinë e pozicioneve të punës të përcaktuara nga Qeveria në klasifikimin e tyre të përgjithshëm.

dhe klasifikohen në njërin nga 14 gradat e pagës.



Shpjegimet narrative në tekstin e projektligjit, janë pasqyruar në formë tabelore:

Kategoritë funksionale të nëpunësve civilë:	Pozitat në kuadër të kategorive funksionale	Grada e pagës	Koeficienti	Paga
1. Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues	- Drejtues i lartë 3	- Grada e pagës 1	- ?	- ? €
	- Drejtues i lartë 2	- Grada e pagës 2	- ?	- ? €
	- Drejtues i lartë 1	- Grada e pagës 3	- ?	- ? €
2. Nëpunës civilë të nivelit drejtues	- Drejtues 4	- Grada e pagës 4	- ?	- ? €
	- Drejtues 3	- Grada e pagës 5	- ?	- ? €
	- Drejtues 2	- Grada e pagës 6	- ?	- ? €
	- Drejtues 1	- Grada e pagës 7	- ?	- ? €
3. Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues dhe profesional	- Ekzekutues dhe profesional 3	- Grada e pagës 8	- ?	- ? €
	- Ekzekutues dhe profesional 2	- Grada e pagës 9	- ?	- ? €
	- Ekzekutues dhe profesional 1	- Grada e pagës 10	- ?	- ? €
4. Nëpunës civilë të nivelit administrativ	- Administrativ 4	- Administrativ 4	- ?	- ? €
	- Administrativ 3	- Administrativ 3	- ?	- ? €
	- Administrativ 2	- Administrativ 2	- ?	- ? €
	- Administrativ 1	- Administrativ 1	- ?	- ? €

Dy kolonat e fundit mbeten të papërcaktuara, për shkak se Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë akte nënligjore për caktimin e koeficienteve me të cilët do të bëhet edhe përlllogaritja e pagës.

Klasifikimi i gradave të pagës bëhet varësisht nga përgjegjësia, kompleksiteti, përgjegjësia vendimmarrëse, aftësitë ndërpersonale, kualifikimet e nevojshme dhe përvoja. Kjo çështje do të saktësohet në mënyrë më të detajuar me një akt nënligjor, që do të nxirret nga Qeveria.

Nëpunësit civilë, puna e të cilëve vlerësohet pozitivisht, në fund të çdo viti kalendarik mund të avancojnë në grada. Mënyrat e avancimit shpjegohen në projektligj. Gjithashtu, nëpunësit civilë do të kompensohen edhe për punën e tyre jashtë orarit, punën në kushte të jashtëzakonshme

(me rrezik për shëndetin), si dhe do të kenë shtesa për kushtet e tregut. Shtesat për kushtet e tregut nënkuptojnë shtesat në paga për ata punonjës, puna e të cilëve paguhet më mirë në sektorin privat se në atë publik. Kjo bëhet me qëllim që kuadrot e tilla të mund të mbahen në punë.

Siç u tha edhe më herët, deri më tash kjo çështje ka qenë e rregulluar me Udhëzimin Administrativ të MSHP 2004/11 për Caktimin e Nivelit të Gradave në Shërbimin Civil. Ekzistojnë 12 koeficiente të pagave në Shërbimin Civil. Përlllogaritja e pagave sipas koeficienteve është bërë duke shumëzuar shumën e pagës bazë me koeficientin e pagës. Pas ngritjes së pagave për 10 për qind në muajin janar, paga bazë është 35 euro (35,805 euro, më saktësisht). Nëse një punonjës ka koeficientin e

pagës 4, që momentalisht është koeficienti më i ulët i pagës, atëherë përlllogaritja e pagës bëhet duke e shumëzuar pagën bazë me 4, pra  $35,805 \times 4 = 143.22$  euro, që shënon pagën më të ulët në Shërbimin Civil. Mënyra e përlllogaritjes së pagës nga MSHP është mbajtur dhe vazhdon të mbahet sekret, pa ndonjë arsye.

Njëjtë si në Projektligjin për Shërbyesit Civilë, edhe në memorandum shpjegues të projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë thuhet se "projektligji nuk i cenon kompetencat e PSSP-së".

Ministria e Administratës Publike, e cila i ka hartuar këto dy projektligje, duhet t'i largojë nga përdorimi deklaratat e tilla, ngase faktikisht PSSP nuk ka kompetenca legjislative.



## Qeveria ndryshon Ligjin për Skemën e Ndihmës Sociale

**A** fërsisht gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale parasheh që të ashpërsohen kriteret për familjet të cilat nuk janë në nevojë sociale dhe nuk do të mund ta realizojnë ndihmën sociale, rezultat i së cilës mund të jetë zvogëlimi i përfituesve të ndihmave sociale. Nga ana tjetër, do të bëhet rritja e numrit të përfituesve të ndihmave sociale për disa kategori të familjeve dhe do të ngriten përfitimet financiare për ato familje që do të kenë të drejtë përfitimi të

ndihmave sociale. Si pasojë e këtyre ndryshimeve në ligj, afro 10.000 familje do të largohen nga skema e ndihmës sociale, duke bërë që të kursehen 6.5 milionë euro. Familjet që do të mbesin jashtë skemës së ndihmës sociale janë familjet që kanë dy e më shumë anëtarë të aftë për punë (2.370 familje, që momentalisht marrin nga 60 euro), personat që realizojnë pension themelor dhe pension të aftësisë së kufizuar (4.655 familje,

që marrin nga 40 euro), familjet që llogariten të kenë automjete funksionale (3.300 familje, që marrin nga 60 euro), si dhe familjet që llogaritet ta kenë një fëmijë të moshës 1-18 vjeçare me aftësi të kufizuar (300 familje, që marrin nga 60 euro).

Krahas largimit të këtyre 10.000 familjeve dhe kursimit të 6.5 milionë

80 për qind në 60 për qind (të cilat gjithashtu do të përfitojnë nga 60 € në muaj); 5.055 familje të reja - të cilat nuk kanë mundur të përfitojnë sipas kriterëve të ligjit aktual - do të përfshihen në skemën e ndihmës sociale. Këto familje janë: familjet në hasmëri, familjet që kanë mbetur nën përkujdesje të grave dhe që jetojnë në vendbanime të thella malore në brezin kufitar, familjet që kanë anëtarë narkomanë, ose të trafikuar, familjet që janë të marginalizuara dhe nuk janë të integruara në arsim, punësim dhe shërbime të tjera publike. Për kriteret e përfitimit të këtyre familjeve, MPMS do ta nxjerrë një akt më të detajuar nënligjor.

Përveç ndryshimeve të kriterëve për përfitim të ndihmave sociale, projektligji parasheh edhe delegimin e kompetencave për menaxhimin e skemave të ndihmës sociale nga niveli qendror në atë lokal. Tash e tutje, Qendrat për Punë Sociale, si përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale, do të administrohen nga komunat, kurse MPMS do të ketë rol menaxhues dhe mbikëqyrës. Sipas ligjit aktual, Qendrat për Punë Sociale administrohen dhe menaxhohen tërësisht nga MPMS.

Si ndryshim tjetër parashihet edhe

Për shkak të paqartësive, vështirësive dhe gabimeve në Ligjin aktual për Skemat e Ndihmës Sociale, Qeveria ka miratuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemat e Ndihmës Sociale.

eurove, me skemën e re të ndihmës sociale parashihen përfitime tjera për 9.265 familje, me një ndihmë prej 60 euro në muaj dhe 52.695 individë që do të përfitojnë nga 5 euro shtesë në muaj. Për këto përfitime të reja nevojiten 9.8 milionë euro shtesë. 2.526 familje llogaritet të përfshihen në skemën e ndihmës sociale nga rritja e sipërfaqeve dhe klasifikimit të tokës (familje të cilat do të përfitojnë nga 60 euro në muaj); 1.680 familje do të përfshihen në skemën e ndihmës sociale si pasojë e uljes së shkallës së aftësisë nga

zgjatja e periudhës së shfrytëzimit të ndihmës sociale nga 6 në 12 muaj. Me këtë ndryshim do të evitohen procedura të tepërta administrative, kurse aplikuesit dhe vetë MPMS do të kursehen nga shpenzimet.

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2009-2012, nga Buxheti i Kosovës çdo vit ndahen 27.3 milionë euro për skemat e ndihmës sociale dhe administrimin e tyre. Ndërsa, nëse ligji i ri hyn në

e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në njërën anë kemi kërkesën e MPMS-së për ndryshim të Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale, e në anën tjetër kemi deklaratën e MEF-it kundër miratimit të këtij projektligji për shkak të kostos së papërbalueshme financiare. Edhe pse ka kundërshtime në mes të këtyre dy Ministrive, Qeveria ka miratuar projektligjin dhe ia ka dërguar Kuvendit për miratim.

Çfarë do të ndodhë nëse Kuvendi miraton projektligjin në këtë format dhe ligji hyn në fuqi, kurse Qeveria nuk mund ta zbatojë atë për shkak të mjeteve buxhetore?

Me fjalë të tjera, Qeveria ka kërkuar miratimin e një ligji të cilin nuk do të jetë e aftë ta zbatojë. Mbetet të shihet se si do të veprojë Kuvendi i Kosovës me këtë projektligj, respektivisht, nëse do ta miratojë apo jo.

Hyrja në fuqi e ligjit të ri do ta rëndojë Buxhetin e Kosovës për 3.3 milionë euro shtesë, ose gjithsej 30.6 milionë euro, nëse i llogarisim edhe mjetet aktuale që shpenzohen çdo vit. Sipas MEF, kjo kosto shtesë buxhetore është e papërbalueshme për Buxhetin e Kosovës, prandaj ligji i ri do të jetë i pazbatueshëm.

Nëse analizohet memorandum i shpjegues i MPMS-së për projektligjin në fjalë, del se ligji aktual ka pasur paqartësi të shumta dhe zbatuesit e tij kanë hasur në probleme në praktikë. Mirëpo, sipas deklaratës financiare të MEF-it, projektligji është i papërbalueshëm për Buxhetin e Kosovës. Dhe, si i tillë, nuk duhet të miratohet.

fuqi, kostoja buxhetore do të rritet për 3.3 milionë euro për vit dhe Ligji i ri për Skemën e Ndihmës Sociale do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës 30.6 milionë euro në vit. Këto mjete buxhetore shtesë nuk janë të parapara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Sipas MEF-it, rritja e skemave sociale është në kundërshtim me rekomandimet

## Projektligji për Qeverinë pëson ndryshime rrënjësore

Në shkurt të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka themeluar Grupin Qeveritar për Harmonizimin dhe Finalizimin e Projektligjit për Qeverinë. Për themelimin e Grupit dhe përmbajtjen e projektligjit, kemi shkruar në numrin e dytë të GAP Monitor. Grupi Qeveritar ka pasur për detyrë t'i harmonizojë qëndrimet e ekzekutivit ndaj këtij ligji dhe ta finalizojë tekstin e projektligjit. Mirëpo, ky Grup ka bërë disa ndryshime në draftin e Projektligjit për Qeverinë. Ndryshimet më të

emërojë deri në 5 këshilltarë politikë, me ndryshimet që i janë bërë këtij projektligji, Kryeministri ka të drejtë t'i emërojë deri në 10 këshilltarë politikë. Në draftin e kaluar thuhej se Zëvendëskryeministrat kanë të drejtë t'i emërojnë deri në 3 këshilltarë politikë, kurse me draftin e ri ata mund t'i emërojnë deri në 5. Ministrat tash do të kenë të drejtë t'i emërojnë deri në 5 këshilltarë politikë, kurse me draftin e kaluar atyre u jepej e drejta që t'i emërojnë 2 deri në 4 këshilltarë politikë. Gjithashtu, drafti

Qeveritar, e ka larguar tërësisht këtë pjesë për kufizimin e posteve të Zëvendësministrave.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, Grupi Qeveritar për harmonizimin dhe finalizimin e tekstit të Projektligjit për Qeverinë ka bërë ndryshime rrënjësore. Ndryshimet e bëra në projektligj nuk e prekin strukturën e Qeverisë, sikurse parashihej me draftin e kaluar të projektligjit. Grupi Qeveritar është kujdesur që ta kufizojë numrin e Ministrave pa portofol, dhe si rrjedhojë numri i Ministrive aktuale do të mbetet i paprekur, ani pse Qeveria e Kosovës ka numrin më të madh të Ministrive në krahasim me vendet e vogla në BE.

Gjithashtu, me ndryshimet e bëra, Grupi Qeveritar është kujdesur t'i ruajë postet e këshilltarëve politikë aktual dhe atyre të Zëvendësministrave. Deri pas zgjedhjeve të 2011, struktura e Qeverisë nuk do të ndryshojë.

Grupi Qeveritar, i cili ka pasur për detyrë ta harmonizojë dhe finalizojë draftin e projektligjit, është kujdesur që t'i ruajë pozitat e këshilltarëve politikë aktualë dhe ato të Zëvendësministrave, duke e ndryshuar draftin e projektligjit

mëdha kanë të bëjnë me kufizimin në dy Ministra pa portofol, ndryshe nga drafti i kaluar - ku Ministrat pa portofol nuk kufizoheshin në numër. Sërish rritet numri i këshilltarëve politikë. Përderisa në draftin e kaluar thuhej se Kryeministri ka të drejtë t'i

i kaluar i projektligjit specifikonte se Zëvendësministrat do të emërohen vetëm në ato Ministri që mbulojnë një fushë të gjerë të aktiviteteve, e jo në të gjitha Ministrinë, kurse drafti final që i është dërguar Kuvendit, pas ndryshimeve të bëra nga Grupi



## 36.830 euro për organizimin e “Bursës së Punësimit”

Në mbledhjen e 23 prillit 2009, Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që në bashkëpunim me Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB), ta organizojë “Bursën e Punësimit Kosova 2009”.

Për këtë qëllim, Qeveria e

Kosovës ka lejuar përdorimin e 36.830 eurove, ndërsa bursa është mbajtur me 4 dhe 5 maj 2009. Sipas raporteve të AKB-së, gjatë dy ditëve të mbajtjes së bursës, janë pranuar 578 aplikacione, me ç’rast 75 persona kanë lidhur kontratë pune. Bursa do të vazhdojë

gjatë tërë vitit 2009. AKB edhe më tutje është duke pranuar aplikacione për punë, kurse në muajin qershor do ta bëjë publik numrin e tërësishëm të aplikacioneve që janë marrë dhe do të përpiqet që të punësojë edhe më shumë punonjës deri në fund të vitit.

## Miratohet Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë

Me vendimin e Qeverisë numër 16/61, është miratuar Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë. Projektligji i është dërguar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Deri më tash, deklarimi i pasurisë së zyrtarëve publikë është rregulluar me Ligjin Kundër Korrupsionit. Zyrtarët e lartë publikë kanë qenë të obliguar që ta bëjnë deklarimin e pasurisë tek Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit (AKK). Nëse nuk bëhet deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve, sipas Ligjit Kundër Korrupsionit, AKK i kërkon institucionit përkatës ndërmarrjen e

masave ndëshkuese për zyrtarët e caktuar, prej ndalesës së pagës deri te shkarkimi.

Sipas të dhënave të AKK-së, 747 zyrtarë publikë janë të obliguar që çdo vit ta bëjnë deklarimin e

vetëm 14 nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre. I njëjti numër i zyrtarëve është edhe në vitin 2008. 14 zyrtarët publikë që nuk e kanë deklaruar pasurinë janë pjesëtarë të minoriteteve dhe janë anëtarë

Deri më tash, deklarimi i pasurisë është bërë në Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në Ligjin kundër Korrupsionit, ndërsa në të ardhmen kjo çështje do të rregullohet me ligj të veçantë.

pasurisë. Në bazë të raporteve të AKK-së, deri me 2 prill 2007, vetëm 67.07 për qind e zyrtarëve të lartë publikë kanë deklaruar pasurinë. Sipas Raportit Vjetor të AKK-së për 2007, nga 732 zyrtarët publikë

të Kuvendit të Kosovës, Gjykatave dhe Prokurorisë. Ndonëse AKK ka kërkuar nga institucionet, ku ata punojnë, ndërmarrjen e masave për shkarkimin e tyre, deri më tash nuk është marrë asnjëmasë ndëshkuese.

Në anën tjetër, edhe zyrtarët që kanë bërë deklarin e pasurisë, nuk e kanë deklaruar atë në mënyrë të duhur. 37.4 për qind e formularëve janë plotësuar në mënyrë jo të rregullt, në 28.9 për qind të rasteve nuk janë deklaruar të hyrat vjetore, 7.3 për qind e zyrtarëve nuk kanë ofruar informacion të nevojshëm për pasurinë e paluajtshme, kurse në 6.9 për qind të rasteve ka mungesa të deklarin të parave të gatshme, informatave familjare, etj.

Këto të dhëna janë indikacione se deri më tash nuk ka ekzistuar seriozitet nga zyrtarët publikë për ta bërë deklarin e pasurisë së tyre, por as nga ana e institucioneve publike për të kërkuar përgjegjësi ligjore nga këta zyrtarë. Shpresohet se këto probleme do të mund të zgjidhen përmes Ligjit për Deklarin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë. Ky ligj rregullon kontrollin publik të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të hyrat dhe përfitimet e tjera materiale, detyrimet e tyre financiare, ato të anëtarëve të familjes dhe personave të lidhur me ta, duke përfshirë edhe sanksionet e përcaktuara.

Deklarimet e pasurisë së zyrtarëve publikë kanë të bëjnë me patundshmëri, pasuri të luajtshme në vlerë të madhe (mbi 3.000 euro), aksione në shoqëri komerciale, letra

me vlerë, para të gatshme, borxhe, të hyra vjetore.

Projektligji parasheh katër lloje të deklarin të pasurisë: deklarin i rregullt vjetor, deklarin me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, deklarin sipas kërkesës së Agjencisë, si dhe deklarin pas largimit nga funksioni.

Të gjitha deklarinet e pasurisë së zyrtarëve publikë do të përmbliohen në një regjistër. Çdo qytetar mund të kërkojë qasje në këta regjistra, konform Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Nga praktikat e deritashme, deklarin i pasurisë nuk është bërë në mënyrë të duhur dhe në afatet e parapara kohore, madje ka pasur edhe raste kur zyrtarët publikë nuk kanë deklaruar fare pasurinë e tyre në AKK. Mbetet të shihet sa do të ndikojë në përmirësimin e kësaj gjendjeje hyrja në fuqi e këtij ligji.

Një gjë e tillë deri më tash nuk ka qenë e mundur, pasi qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile, nuk u është lejuar që të kenë qasje në regjistrat e deklaratave të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Sipas tekstit të projektligjit, Agjencioni është i obliguar që t'i ruajë regjistrat deri në 10 vjet nga dita e përfundimit të postit të zyrtarit publik.

Projektligji parasheh gjoba konkrete për ata që nuk e deklarojnë pasurinë. Prej 300-1000 euro dënohet zyrtari publik për mosdeklarin të

rregullt vjetor të pasurisë. Prej 150-500 euro dënohet zyrtari i cili nuk e deklaroi pasurinë me rastin e marrjes së detyrës. Prej 500-1500 euro gjobë dënohet zyrtari i cili nuk e deklaroi pasurinë pas kërkesës së AKK-së. Prej 150-500 euro dënohet zyrtari i cili nuk e deklaroi pasurinë me rastin e përfundimit të detyrës zyrtare. Gjithashtu, prej 150-500 euro dënohet zyrtari i cili e plotëson gabimisht formularin e AKK-së dhe nuk i përmirëson gabimet brenda 15 ditëve. Nëse edhe pas këtyre masave zyrtari publik nuk bën dorëzimin

e të dhënave të pasurisë, atëherë fillohet procedura për shkarkim nga detyra.

Hyrja në fuqi e Ligjit për Deklarin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë nuk do të ndikojë në Buxhetin e Kosovës, ngase AKK, si implementuese e këtij ligji, e ka të ndarë një

buxhet vjetor me të cilin mund t'i mbulojë edhe obligimet që dalin nga ky ligj. Megjithatë, AKK ka deklaruar vazhdimisht se numri i stafit prej 35 vetave nuk është i mjaftueshëm, marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe përgjegjësisë që ka ky Agjencion. Hyrja në fuqi e Ligjit mund të krijojë të hyra për Buxhetin e Kosovës, në rast se zyrtarët publikë nuk e deklarojnë pasurinë, pasi ndaj tyre do të ndërmerren masa me gjoba financiare.


## Formohet Grupi Punues për Hartimin e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë

Pas miratimit të Projektligjit për Qeverinë, Qeveria e Kosovës mori vendimin nr. 27/61, me të cilin formoi Grupin Punues për Hartimin e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë. Rregullorja parashihet të nxirret edhe në bazë të nenit 32.2 të Projektligjit për Qeverinë. Anëtarë të Grupit Punues për hartimin e kësaj rregulloreje janë caktuar: Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e

Shërbimeve Publike, Ministria e Drejtësisë, Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministra e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës dhe Presidenca.

Grupi Punues do të koordinohet nga Zyra e Kryeministrit. Mund të formohen edhe nëngrupe punuese, varësisht nga nevojat e punës. Sipas vendimit 27/61, Rregullorja për

Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë duhet të hartohet brenda tre muajsh. Se sa do të respektohet ky afat kohor, prej tre muajsh, do të shihet pas 24 korrikut 2009, kur do të raportojmë sërish për përmbajtjen e kësaj rregulloreje dhe për respektimin e afatit kohor prej tre muajsh.



## Merren masa kundër “Gripit të Derrave”

Pas alarmit të dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, dhe pas masave të ndërmarra nga shumë shtete, edhe Qeveria e Kosovës ka marrë masa për t'u mbrojtur nga pandemia më e re – “Gripit të Derrave”.

Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës ka ndarë 120.000 euro për blerjen emergjente të medikamentit “Tamiflu”. Me këto mjete, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, janë blerë 10.000 doza “Tamiflu” dhe janë

në procedurë për t'u blerë edhe 10.000 të tjera. Para blerjes së këtyre 20.000 dozave, në

Shpezëve”. Edhe organizatat e huaja kanë dhënë donacione për blerjen e “Tamiflu”. Sipas zyrtarëve

Ndahen 120.000 euro për blerjen e 20.000 dozave ‘Tamiflu’, mirëpo në rast se ky grip prek edhe Kosovën, ‘Tamiflu’, si masë e vetme, nuk do të japë rezultate. OBSH, në bashkëpunim me kompanitë më të njohura farmaceutike, është duke u munduar ta gjejë vaksinën shëruese ndaj kësaj sëmundje

magazinat e MSH-së kanë qenë të ruajtura edhe 2.500 doza, të blera në kohën e rrezikut nga “Gripit i

të MSH-së, Kosova do t'i ketë gjithsej 25.000 doza “Tamiflu”.

16

## Sërish miratohet Strategjia Kundër Korrupsionit 2009-11

Në mbledhjen e 61-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur me 23 prill 2009, Qeveria e Kosovës sërish ka miratuar Strategjinë Kundër Korrupsionit 2009-2011. Për herë të parë, kjo strategji është miratuar me 24 dhjetor 2008, kur i ishte dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim. Para se strategjia të futej në rendin e ditës së seancës në Kuvendin e Kosovës, organizatat e shoqërisë civile, si KDI, FOL'08, INPO dhe ÇOHU, kundërshtuan këtë strategji, me arsyetimin se gjatë hartimit të saj

nuk janë marrë për bazë sugjerimet e shoqërisë civile, ndërsa dokumenti si i tillë nuk ofron një bazë të mirë për luftimin e korrupsionit, pasi që në të nuk ka plan dhe objektiva të qarta.

Në shkurt të këtij viti, deputetët e Kuvendit të Kosovës refuzuan ta miratojnë Strategjinë Kundër Korrupsionit 2009-11, me arsyetimin se ajo nuk ishte përmbajtjesore dhe nuk e kishte të bashkangjitur planin e veprimit

Në seancën e 26 shkurtit 2009, Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi këtë strategji, me arsyetimin se

është tepër e përgjithësuar, pa masa konkrete veprimi dhe pa afate kohore.

Strategjia e kundër Korrupsionit 2009-2011, i është dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim.

Drafti i strategjisë është përgatitur nga Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit (AKK) dhe i është dërguar Qeverisë për shqyrtim dhe miratim.

Sipas Ligjit Kundër Korrupsionit, AKK

është agjencion i pavarur dhe i raporton Kuvendit të Kosovës për punën e tij. Mirëpo, në të njëjtin ligj,

gjithashtu, thuhet se strategjia e AKK-së duhet t'i dërgohet Qeverisë para se ajo të dërgohet në Kuvend, kurse Qeveria mund ta ndryshojë tekstin e strategjisë para se ta dërgojë në Kuvend. Ky fakt e bën AKK-në të varur edhe nga Qeveria, çfarë nuk do të duhej të ndodhte me një agjencion të pavarur.

Sidoqoftë, edhe përkundër faktit se Qeveria e Kosovës në vendimin e

saj 24/61 për miratimin e Strategjisë Kundër Korrupsion 2009-2011, ka kërkuar nga Sekretaria që strategjia t'i dërgohet Kuvendit për miratim, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Strategjia nuk është dërguar në Kuvend, me arsyetimin se ende është duke u punuar në të, prandaj as drafti i saj aktual nuk është bërë publik. Njëkohësisht është duke u punuar në Planin e Veprimit për

këtë strategji, i cili do t'i dërgohet Kuvendit për miratim, së bashku me strategjinë. Herën e fundit kur është debatuar për Strategjinë Kundër Korrupsion 2009-2011, një nga kërkesat e deputetëve ka qenë që Plani i Veprimit t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim. Tashmë po hymë në pjesën e dytë të vitit 2009, kurse strategjia ende nuk ka hyrë në fuqi.

## Ndryshohet Ligji Kundër Korrupsionit

Më 22 prill 2004, Kuvendi i Kosovës ka miratuar për herë të parë Ligjin Kundër Korrupsionit. Me këtë ligj është formuar edhe Agjencioni Kundër Korrupsion (AKK), si institucion kryesor në luftimin e korrupsionit.

Tash, pas pesë vjetësh, sërish kërkohet miratimi i një ligji të ri Kundër Korrupsion.

qëllim që t'i dërgojë në Kuvend.

Edhe pas këtij rasti, vazhdon të bëjë ndryshime në tekstin e projektligjeve.

Sipas një drafti të siguruar nga Instituti GAP, projektligji ri nuk synon ta ndryshojë ose plotësojë ligjin në fuqi, por ta zëvendësojë atë në tërësi. Projektligji ri është i strukturuar ndryshe nga ligji

aktual, thuhet se AKK përgatit strategjinë për Qeverinë, e cila duhet të miratohet nga Kuvendi. Kurse, në projektligjin e ri thuhet se AKK përgatit strategjinë për Qeverinë, në bashkëpunim me Këshillin e Agjencisë, Qeverinë dhe institucionet tjera joqeveritare, e cila duhet të miratohet në Kuvend.

Sipas ligjit aktual, AKK paraqet raportin njëvjeçar, aprovuar nga Këshilli, dhe që duhet miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kurse, me projektligjin aktual, thuhet se AKK i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Këshillit çdo 6 muaj për punën e Agjencisë.

Këshilli mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.

Me ligjin aktual, thuhet se Drejtori i AKK-së, ndër të tjera, duhet të jetë mbi 35 vjeç, kurse projektligji i ri nuk kufizon moshën për përzgjedhjen e tij. Përderisa, sipas ligjit aktual, Drejtori zgjidhet nga Kuvendi, por nuk thuhet me sa vota; projektligji i ri thekson se Kuvendi zgjedh Drejtorin e AKK-së me shumicë të thjeshtë të votave.

Me projektligjin e ri nënvizohet se paga e Drejtorit të AKK do të jetë e barasvlershme me pagën e një Kryetari të Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës, që i bie se Drejtori i AKK-së do të ketë një pagë në mes 1300-1400 euro në muaj.

Projektligji i miratuar në Qeveri, më 23 prill, nuk i është dërguar ende Kuvendit të Kosovës për shqyrtim. Projektligji i ri do ta zëvendësojë në tërësi ligjin aktual që është në fuqi, duke i bërë disa ndryshime në strukturë dhe përmbajtje. Këtë vit, është marrë iniciativë për nxjerrjen e ligjeve të reja dhe ndryshimin e atyre ekzistuese - që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit në Kosovë

Në mbledhjen e 61-të, Qeveria e Kosovës, me vendimin 25/61, ka miratuar Projektligjin Kundër Korrupsionit.

Posipaskëtijvendimi, Sekretaria e Kryeministrit obligohet që projektligjin e miratuar t'ia dërgojë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Mirëpo, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Deri më 15 maj 2009, projektligji nuk i është dërguar Kuvendit për shqyrtim, ashtu siç thuhet në vendim të Qeverisë. Sipas zyrtarëve të Qeverisë dhe të Agjencionit Kundër Korrupsion, projektligji nuk i është dërguar Kuvendit ngase ende është duke u punuar në të.

Ky nuk është rasti i parë kur Qeveria aprovon projektligje, me

aktual në fuqi. Përderisa ligji në fuqi ka 53 nene, projektligji që do ta zëvendësojë atë është më i shkurtër dhe përmban vetëm 28 nene.

Ndryshimet që parashihen kanë të bëjnë me një sërë çështjesh për mbarëvajtjen e punës së Agjencisë.

Përderisa me ligjin aktual thuhet se AKK financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, në bazë të kërkesës për fonde nga Agjencioni, aty nuk theksohet se kush duhet ta aprovojë buxhetin e Agjencionit.

Me projektligjin e ri, thuhet se buxhetin e AKK-së duhet ta aprovojë Kuvendi i Kosovës, si themelues i AKK-së. Në ligjin

## Ndryshohet Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 2 nëntor 2007. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 14 qershor 2008, pas shpalljes nga PSSP.

Ky është ligji i fundit, për hyrjen në fuqi të të cilit është dashur të pritet miratimi i PSSP-së.

Ende pa u bërë një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Qeveria e Kosovës kërkon ndryshimin dhe plotësimin e tij, me arsyetimin se në ligjin aktual janë evidentuar zbrazëtira të mëdha ligjore - të cilat nuk mund të mbulohen me akte nënligjore.

Ligji për Parandalimin e

Konfliktit të Interesit ka për qëllim që të parandalojë konfliktin mes interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit, në ushtrimin e funksionit publik.

Ndryshimet që parashihen, kryesisht kanë të bëjnë meriemërtim të organeve dhe funksioneve publike, si për shembull fjala "agjencion" zëvendësohet me "agjenci"; fjala "kryeshef ekzekutiv" zëvendësohet me fjalën "drejtor i administratës dhe personelit" (kjo ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është shuar posti i kryeshefit ekzekutiv).

Gjithashtu, me ndryshimet e parapara, planifikohet që listës së zyrtarëve publikë t'i shtohen edhe

Guvernatori i Bankës Qendrore, Komandanti i FSK-së, Drejtori i AKI-ut, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i ATK-së, Drejtori i Doganave, udhëheqësit e KRPP-së dhe OSHPP-së, udhëheqësi i AKP-së, etj.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) do të ketë për detyrë ta zbatojë këtë ligj. Ky projektligj nuk bart kosto shtesë buxhetore, ngase AKK tashmë ka të ndarë buxhetin për këtë çështje. AKK operon me një staf prej 35 vetash dhe buxheti i saj vjetor për 2009 është 504.553 euro.

## Më në fund, zgjidhen anëtarët e Bordit të Trustit Pensional

Me vendimin 23/61, Qeveria e Kosovës i dha mbështetje Kuvendit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, i cili ka qenë pa bord, që nga shtatori i vitit 2008 deri në prill të vitit 2009. Në muajin prill, anëtarët të Bordit të Trustit Pensional, me mandat trevjeçar, u zgjodhën: Besim Beqaj, Ymer Havolli, Ruzhdi Osmani, Angela Berns, Steve Bates dhe Harvey Richard Kember.

Trusti i Kursimeve të Kosovës ka filluar të tregojë trende pozitive pas rënieve të vitit 2008 dhe fillimvitit 2009. Në vitin 2008, neto kthimet

kanë qenë negative për 29 për qind. Vlera e aksionit gjatë këtij viti ka rënë në 0.86 euro, ndërkaq gjatë vitit 2007 vlera e aksioneve ishte 1.22 euro. Në 2008, humbjet reale ishin 240.000, euro si pasojë e shitjes së aksioneve nga disa aksionarë. Rëniët e vlerës së aksioneve kanë vazhduar edhe në dy muajt e parë të vitit 2009, por në muajt mars dhe prill, si rezultat i stabilizimit të tregjeve financiare botërore, ka pasur përmirësim në situatën e trustit dhe vlera e kthimeve në këtë periudhë ka qenë 22 milionë euro. Humbjet e dy muajve të parë të vitit 2009 janë kthyer në tërësi.

BQK ka intervenuar vetëm në shtator të vitit 2008, duke ndaluar

investimin e mëtejshëm të mjeteve në tregjet financiare botërore, në vlerë prej 60 milionë eurosh. Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së, ka deklaruar se ligji aktual për kursimet pensionale dhe mungesa e bordit kanë pamundësuar çfarëdo intervenimi tjetër.

Sipas raportit të vitit 2007, në Trust ishin vendosur 279 milionë euro, prej të cilëve 272 milionë janë investuar në tregjet globale - 55 për qind në aksione dhe 45 për qind në asetë, në shtete të ndryshme. Në Trust kanë investuar 266.000 kontribuues. Sipas Ligjit për kursimet pensionale, BQK ka mundësi të intervenojë, nëse rezikohen 10 për qind e kursimeve.



## Rinia bëhet me ligj të vetin

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 60-të me radhë, e të parën gjatë muajit prill, me vendimin 09/60 ka miratuar Projektligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. Projektligji është hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), e cila do ta bëjë implementimin e tij, pas miratimit në Kuvend.

Projektligji përbëhet nga gjithsej 20 nene. Sipas nenit 1, qëllimi i këtij projektligji është "Avancimi dhe riafirmimi i vazhdueshëm i pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, në zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre në shoqëri".

në Kosovë dhe paraqet formacion këshillues për çështje rinore.

Në nivelin lokal, këtë përgjegjësi e mban Këshilli Lokal i Veprimit Rinor, i cili është formacion këshillues i organizatave rinore që veprojnë në nivel lokal.

Projektligji definon edhe statusin e qendrave rinore. Qendrat rinore ofrojnë hapësirë për programet dhe veprimtaritë e të rinjve. Qendrat rinore licencohen nga drejtoritë, ose departamentet komunale për rini, në bazë të një udhëzimi që do ta nxjerrë MKRS.

Gjithashtu, projektligji përshkruan edhe veprimtarinë vullnetare të të rinjve.

Të rinjtë, me rastin e kryerjes së punës vullnetare, duhet të lidhin një kontratë për punë vullnetare me

për Rininë, udhëzim administrativ për licencimin e qendrave rinore, dhe udhëzim për caktimin e formave dhe mënyrave të edukimit joformal.

Hartimi i këtyre tri akteve nënligjore do të vlejë 5.000 euro. Nuk është e qartë se për çfarë do të duhej të shpenzoheshin 5.000 euro me rastin e hartimit të akteve nënligjore, kur kjo kosto do të duhej të mbulohej nga paga që marrin zyrtarët ligjorë në MKRS.

Hyrja në fuqi e këtij ligji, Buxhetit të Kosovës do t'i kushtojë 381.000 euro për periudhën korrik 2009-2011. Për vitin 2009, nuk janë paraparë mjete me Buxhetin e Kosovës për këtë qëllim. Këto mjete do të shfrytëzohen për krijimin e mekanizmave për konsultim të rregullt me organizatat rinore, në nivel qendror dhe lokal (42.000 euro); implementimin e obligimeve që dalin nga pjesa e punës vullnetare (50.000 euro); shpenzime lidhur me monitorimin e implementimit të ligjit me licencimin e qendrave rinore (10.000 euro); hartimi i akteve nënligjore (5.000 euro); dhe zhvillimi i pjesës së edukimit jo-formal (20.000 euro).

Sipas deklaratës së Agjencionit për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrim Evropian (AKZHIE), Projektligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë nuk cenon parimet e acquis.

Kjo agjenci ka bërë edhe përmirësime të shumta gjuhësore në draftin e gjuhës angleze të këtij projektligji. Siç duket, departamentet për përkthim në MKRS nuk janë në nivel profesional, ngase lëshimet e tyre duhet t'i mbulojë AKZHIE, detyrë e së cilës nuk janë përmirësimet gjuhësore.

Projektligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë është dokument i cili deklaron angazhimin e institucioneve të vendit për fuqizim të rinisë, por nuk ofron diçka konkrete në këtë drejtim

Sipas projektligjit, të rinj mund të quhen ata që kanë moshën 15-24 vjeç. Projektligji nuk përmban asgjë konkrete në përjashtim të një zotimi se institucionet do të angazhohen për fuqizim të rinisë. Projektligji deklaron se të rinjtë do të trajtohen në mënyrë të barabartë me strukturat tjera të shoqërisë. Një deklarami i tillë i përngjan një deklaratë të të drejtave të njeriut. Projektligji definon përgjegjësitë e nivelit qendror dhe atij lokal ndaj të rinjve.

Sipas Projektligjit, organi përgjegjës për rini në nivelin qendror është Këshilli i Veprimit Rinor. Ky këshill është organizim vullnetar i organizatave rinore që veprojnë

organizatorin. Periudha e punës vullnetare duhet të njihet si përvojë pune. Kjo do të konsiderohet si përparësi në rast të konkurrimit për punësim. Definimi i punës vullnetare - si stazh pune - është përfitimi i vetëm konkret që ky ligj i ofron rinisë. Kjo ngase të rinjtë mund të nxiten më shumë për punë vullnetare, dhe në të njëjtën kohë të fitojnë përvojë pune - e cila shumë të rinjve u mungon dhe shpesh s'kualifikohen në konkurset e ndryshme për punë.


MKRS, brenda gjashtë muajve të hyrjes së ligjit në fuqi, ka për obligim që të nxjerrë urdhëresë administrative për caktimin e ministrive kryesore që kanë përgjegjësi për zbatimin e Ligjit

## Qeveria ndan 7.000 euro për Familjen e Erion Foniqit, fëmijës që humbi jetën nga kafshimet e qenve endacakë

Në mbledhjen e 23 prillit 2009, Qeveria e Kosovës ka ndarë 7.000 euro për familjen Foniqi, nga fshati Karaqevë, i Komunës së Kamenicës.

Në mars të këtij viti, fëmija tetëvjeçar, Erion Foniqi, derisa po kthehej nga shkolla - humbi jetën nga kafshimet e qenve endacakë. Ky rast tragjik

ngjalli reagime të shumta në drejtim të institucioneve lokale dhe qendrore, të cilat nuk kanë marrë masa për eliminimin e qenve endacakë.



## 39.736 euro për “Festivalin e Lirisë”

Me iniciativë dhe kërkesë të Radios “Urban FM”, Qeveria e Kosovës ka ndarë 39.736 euro për organizimin e festivalit muzikor ndërkombëtar, për nder të 10 vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Festivali do të mbahet më 12 dhe 13 qershor 2009, në parkun e Gërmisë. Mepunëtorizative do të merret “Urban FM”, nën mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit. Sipas organizatorëve nga “Urban FM”, ideja për një festival të këtillë muzikor, me përmasa ndërkombëtare, ka ekzistuar edhe më herët, mirëpo vetëm tash ka gjetur mbështetjen financiare nga

Qeveria. Shpresohet se, që nga ky vit, ky festival të jetë tradicional. Përpos 39.736 eurove të Buxhetit

se do të sjellin artistë të njohur ndërkombëtarë, ndër të cilët edhe këngëtarin amerikan Fat Joe.

Këto mjete ndahen nga Rezervat e Paparashikuara të Qeverisë. Sipas Buxhetit të Kosovës për 2009, Rezervat e Paparashikuara kapin shumën prej 2.5 milionë euro. Në katër mujorin e parë të 2009, Qeveria e Kosovës ka marrë shtatë vendime me të cilat ndan mjete nga fondi i “rezervave të paparashikuara.” Deri më tash, nga ky fond janë ndarë 635.438 euro, ose 25.4 % e mjeteve të fondit

të Kosovës, ndihmë financiare kanë dhënë edhe PTK, British Airways, si dhe Zyra Norvegjeze. Organizatorët kanë premtuar

Mbetet të shihet se sa do të mund të ruhet ambienti i gjelbëruar, pas dy ditëve të këtij koncerti.

## 30.000 euro për ngritjen e shtatores së dëshmorit Adrian Krasniqi

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 04/62, janë ndarë 30.000 euro për ngritjen e shtatores së dëshmorit Adrian Krasniqi. Këto mjete janë derdhur në konton e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Kosovës – Dega në Pejë. Kjo shoqatë është përgjegjëse për realizimin e

projektit. Përveç këtyre mjeteve të dhëna nga Qeveria, këtë projekt e ka ndihmuar edhe Komuna e Pejës. Ajo ka ndarë tokën për ndërtimin e shtatores, në qendër të qytetit të Pejës, si dhe ka dhënë një shumë rreth 70.000 euro për të ndihmuar edhe familjarët e veteranëve të luftës së UÇK-së.

Adrian Krasniqi (1972-1997) ishte njëri ndër themeluesit e UÇK-së, i cili ra hero më 16 tetor 1997, në Kliçinë. Ndërtimi i shtatores, për nder të tij, do të bëhet në Pejë. Ajo pritet të realizohet deri më 16 tetor 2009, ditë kjo kur bëhen 12 vjet nga rënia e Adrian Krasniqi.

## Zgjerohet lista e personave që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë diplomatike

Me vendimin nr. 05/60, Qeveria e Kosovës ka vendosur që në listën e personave që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta diplomatike - të përfshihet edhe Shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI). Ky vendim i Qeverisë bazohet në Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit dhe në vendimin e mëhershëm të Qeverisë nr. 02/31. Më saktësisht, vendimi 05/60 i 8 prillit 2009 e plotëson vendimin 02/31 të 27 gushtit 2008.

Ligji për Dokumentet e Udhëtimit ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

Sipas tij, ekzistojnë gjashtë lloje të dokumenteve të udhëtimit: pasaporta, pasaporta diplomatike, pasaporta zyrtare, fletudhëtimi - dokument udhëtimi për kthim, dokument udhëtimi grupor, si dhe dokumentet e udhëtimit që lëshohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Ndryshe nga pasaportat e rregullta, të cilat i lëshon Ministria e Punëve të Brendshme, pasaportat diplomatike i lëshon Ministria e Punëve të Jashtme.

Sipas nenit 10, të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, pasaporta diplomatike u lëshohet këtyre personave: Kryetarit të Kosovës, Kryetarit të Kuvendit, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës Supreme, Avokatit të Popullit, punëtorëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, si

dhe misioneve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, prijësve të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, personave që me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare si funksionarë të rangut diplomatik në organizatat përmendura, korrierëve diplomatikë dhe personave të tjerë të caktuar, nëse kjo është në interes të Republikës së Kosovës. Pasaporta

### Deri më tash, Ministria e Punëve të Jashtme ka lëshuar 177 pasaporta diplomatike

diplomatike mund t'u lëshohet edhe anëtarëve të ngushtë të familjes së punëtorëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të misioneve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, anëtarëve të familjes së personit - që me vendimin e Qeverisë shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare, nëse me ta jetojnë në bashkësi familjare të përbashkët jashtë shtetit, si dhe anëtarit të ngushtë të familjes së personit nga paragrafi 1, i cili e shoqëron në udhëtimin zyrtar jashtë shtetit.

Sipas nenit 17, pasaporta diplomatike lëshohet për kohën e kryerjes së detyrës. Por, afati i vlefshmërisë së saj nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet. Pasaporta

diplomatike jepet në bazë të kërkesës së organit shtetëror.

Sipas dispozitave përfundimtare të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, Qeveria e Kosovës, me propozimin e MPJ-së, në afat prej tre muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, cakton kriteret për përcaktimin e interesave të Republikës së Kosovës, në bazë të të cilave mund të lëshohet pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare.

Duke u bazuar në këtë ligj, Qeveria e Kosovës, më 27 gusht 2008, ka marrë vendimin 02/31, i cili edhe një herë ripërsërit postet për të cilat nevojitet pasaporta diplomatike. Në këtë listë nuk është përfshirë edhe Shefi i Agjencisë së Inteligjencës. Në kohën kur është marrë vendimi 02/31, ende nuk ishte emëruar personi që do ta drejtonte këtë agjenci. Më 4 shkurt 2009, Bashkim Smakaj u emërua Shef i Agjencisë së Inteligjencës. Me vendimin 05/60, edhe posti i Bashkim Smakajt përfshihet në listën e personave që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë diplomatike.

Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme, deri më 31 prill 2009, janë lëshuar 177 pasaporta diplomatike. Çdo shtet që ka pranuar pasaportën e Kosovës, ka pranuar edhe pasaportën diplomatike të Kosovës. Deri më tash, 38 shtete kanë pranuar zyrtarisht pasaportat e Kosovës, që nënkupton se edhe pasaporta diplomatike njihet në 38 shtete.

## Miratohet Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 61-të të saj, ka miratuar Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Ligji për Shërbimin e Jashtëm parasheh nxjerrjen e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm brenda tre muajsh, nga hyrja në fuqi e ligjit. Ligji ka hyrë në fuqi më 14 janar 2009, ndërsa Rregullorja është miratuar më 23 prill 2009. Pra, brenda afatit të paraparë ligjor. Rëndësia e kësaj rregulloreje është e madhe, sepse kompletton edhe më shumë bazën ligjore për

funksionimin e politikës së jashtme kosovare.

Ligji për Shërbimin e Jashtëm lëshoi shumë çështje për t'u rregulluar me akte nënligjore dhe me Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Sipas Rregullores, Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës e përbëjnë anëtarët e përhershëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), si dhe misionet diplomatike dhe konsullore në shtetet tjera dhe në organizatat ndërkombëtare.

Rregullorja përcakton detyrat e

shefit të misionit - Ambasadorit, ose ndonjë personi të autorizuar për të ushtruar këtë detyrë.

Kriteret për t'u pranuar një kandidat në Shërbimin e Jashtëm të Kosovës janë: posedimi i shtetësisë së Kosovës, aftësia e plotë për të vepruar, të mos jetë i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, të mos ketë të shqiptuar ndonjë masë disiplinore për përgjashtim nga puna, të jetë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën, të ketë një klasifikim adekuat profesional, ta

njohë mirë së paku një gjuhë të huaj, si dhe ta kalojë provimin pranues të shpallur nga MPJ.

Ndërsa, si kriteret të preferuara numërohen: njohja e gjuhës së shtetit pranues; njohuri për shtetin pranues, ose rajonin ku ndodhet shteti pranues; aftësi integruese në shtetin pranues.

Kohëzgjatja e detyrës në Shërbimin e Jashtëm është katër vjet, duke përjashtuar agjentët konsullorë dhe Konsujt e Nderit - detyra e të cilëve nuk është e kufizuar në kohë.

Rregullorja themelon edhe Komisionin për Grada dhe Disiplinë, i cili ka funksion të gjerë në Shërbimin e Jashtëm. Komisioni për Grada dhe Disiplinë shqyrton rastet e shkeljeve të rënda të etikës dhe të udhëzimeve të Ministrisë ose Ambasadorëve/të ngarkuarve me punë/Shefave të Misionit, veprimeve të jashtëligjshme dhe sjelljeve tjera që janë të pahijshme për një anëtar të Shërbimit të Jashtëm.

Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlefshmërinë e caktimit të gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm, dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës. Komisioni takohet një herë në vjeshtë dhe një

jo-shumicë.

Sipas Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, gradat diplomatike janë: Ambasador, Ministër, Ministër këshilltar, Këshilltar, Sekretar i Parë, Sekretar i Dytë, Sekretar i Tretë dhe Atashe. Ndërsa, gradat

Me Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, që buron nga Ligji për Shërbimin e Jashtëm, formohet një organ i rëndësishëm në Shërbimin e Jashtëm të Kosovës – siç është Komisioni për Grada dhe Disiplinë

herë në pranverë, çdo vit, si dhe çdo herë tjetër sipas nevojës, për të vërtetuar caktimin e gradave dhe për të shqyrtuar ndonjë rast të shkeljeve. Komisionin e përbëjnë shtatë anëtarë: Sekretari i Përhershëm, i cili njëherësh është edhe Kryesues i Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm, dy Ambasadorë që janë në shërbim, një përfaqësues i Zyrës së Presidentit, një përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, si dhe një përfaqësues i komunitetit

konsullorë: Konsull i përgjithshëm, Konsull, Zëvendëskonsull dhe Agjent konsullor. Në masat disiplinore përfshihen: qortimi me shkrim, suspendimi deri në dy vjet nga e drejta për t'u caktuar në post, suspendimi deri në dy vjet nga e drejta për t'u graduar në pozitë, zvogëlimi në gradë dhe largimi nga Shërbimi i Jashtëm - e që nënkupton largim nga puna.

## Ndryshohet Ligji për Pyjet

Kuvendi i Kosovës, për herë të parë, ka miratuar Ligjin për Pyjet, më 13 shkurt 2003. Ligji për Pyjet është ndryshuar për herë të parë më 28 korrik 2004, ku janë bërë sqarime më të thella për gjobat - në rast dëmtimi të pyjeve.

Në mbledhjen e 29 prillit 2009, Qeveria e Kosovës aprovoi Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Pyjet. Qeveria ka arsyetuar ndryshimin e detyrës në Ligjin e Pyjeve - me pretendimin se ligji aktual nuk ka gjetur zbatim në praktikë.

Ligji për Pyjet i vitit 2003, i cili

është në fuqi, është i shkruar keq, i pakuptueshëm gjuhësisht dhe me strukturë jo të rregullt sintaksore. Si i tillë, do duhej të zëvendësohej tërësisht me një ligj të ri. Ndryshimet më të mëdha që parashihen të bëhen në Ligjin për Pyjet kanë të bëjnë me decentralizimin e kompetencave për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pyjeve. Deri më tash, kjo ka qenë kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më saktësisht e Agjencionit Pyjor të Kosovës. Pas miratimit të

ndryshimeve në ligj, kompetencat për menaxhimin e pyjeve do t'u kalohen komunave. Neni 38 i Ligjit për Pyjet parashihte kompetenca të rezervuara për PSSP-në, lidhur me autoritetin përfundimtar në këtë fushë. Ndërsa, me ndryshimet që priten të bëhen, ky nen do të fshihet në tërësi. Ndryshime parashihen edhe për gjobat. Për mosrespektim të dispozitave të këtij ligji, parashihen gjoba nga 400 – 25.000 euro, varësisht nga dëmet që shkaktohen nga personat fizikë dhe juridikë.

## Strategjisë Legjislative 2009 i shtohet edhe Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

Strategjia Legjislative 2009 po zgjerohet me projektligje të reja, për çdo muaj. Në prill, asaj i është shtuar edhe Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Fillimisht, KPM është formuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil. KPM ka qenë agjenci në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe i ka raportuar kësaj Ministrie deri më 27 shkurt 2008, kur PSSP amendamenti Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36.

Tash, KPM është agjenci e pavarur dhe i raporton Kuvendit të Kosovës, kurse Kuvendi ia përcjell raportet Kryeministrit. Mirëpo, Rregullorja e UNMIK-ut 2008/12,

e cila amendamenti Rregulloren 2001/36, nuk parasheh afat kohor deri kur KPM duhet t'i paraqesë raport Kuvendit të Kosovës.

Nëse i referohemi Rregullore së UNMIK-ut 2001/36, funksionete KPM janë: 1) Shqyrtimi i ankesave të parashtruara nga shërbyesit civilë dhe aplikuesit për punë në shërbimin civil të Kosovës; 2) Shqyrtimi i emërimeve në nivel të udhëheqësve të departamenteve; 3) Vlerësimi përkitazi me Parimet Udhëheqëse të Shërbimit Civil.

Sipas Raportit Vjetor të Punës së KPM për vitin 2007, gjatë këtij viti, në KPM, kanë arritur 384 ankesa. Ankesat kanë të bëjnë me këto çështje: 127 ankesa për

ndërprerje të kontratës së punës; 138 ankesa për mospërtëritje të kontratës së punës; 40 ankesa për kontestim të konkursit; 11 ankesa për degradim nga posti; 26 ankesa për kompensim material; etj.

KPM ende nuk ka publikuar raportin vjetor për vitin 2008.

Projektligji për KPM-në, i cili është përfshirë në Strategjinë Legjislative, për këtë vit parasheh që të zëvendësojë Rregulloret e UNMIK-ut, të qartësojë kompetencat dhe detyrimet e KPM-së, si dhe të përshtatet me Ligjin e ri për Shërbimin Civil – që është duke u shqyrtuar në Kuvendin e Kosovës.

## Emërohen anëtarët e Komisionit për Përdorimin e Gjuhëve

Në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Përdorimin e Gjuhëve. Në këtë Komision janë emëruar: Fehmi Stublla - përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit dhe njëherësh Kryesues i Komisionit, Fadil Bytyçi - Përfaqësues i Kuvendit të Kosovës, Bedri Bahtiri - nga Ministria e Drejtësisë, Selami Osmani - Përfaqësues nga Ministria e Shërbimeve Publike, Dragana Zhivković - Përfaqësuese nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve, Nazan Safçi – nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Fitim Tahiri - nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Komisioni për Përdorimin e Gjuhëve, si dhe vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të tij, ka për bazë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Ky ligj ka

për qëllim të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të komuniteteve në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike. Ligji siguron status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe - si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta për përdorimin e tyre në të gjitha institucionet e vendit.

Komisioni për Përdorimin e Gjuhëve është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Gjuhët. Sipas Nenit 32, Komisioni i Gjuhëve do të marrë masa dhe veprime brenda kompetencave të tij për të siguruar njohjen e statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare. Komisioni i Gjuhëve, gjithashtu, mund të kryejë hetime me iniciativë të vet dhe mund të ndërmjetësojë në situatat kur ndërmjetësimi i tillë kërkohet për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Në konkludim të hetimit, Komisioni i Gjuhëve mund të nxjerrë rekomandime për

korrigjimet e kërkuara dhe të rekomandojë përmirësimet. Ligji parasheh nxjerrjen e një udhëzimi administrativ, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, 90 ditë pas shpalljes së ligjit.

Kompetencat, detajet dhe përbërja e Komisionit përcaktohen duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve gjuhësore në Kosovë, si dhe duke marrë parasysh nevojën për të pasqyruar dallimet gjuhësore të komuniteteve në Kosovë.

Në mandatin e kaluar, Komisioni nuk ka qenë funksional. Mirëpo, pas marrjes së vendimit në Qeveri për emërimin e anëtarëve të rinj, Komisioni është në fazën e konsolidimit dhe hartimit të një plani të punës. Komisioni nuk ka ndonjë datë të caktuar se sa herë duhet të mblidhet, por anëtarët kanë vendosur të takohen një herë në muaj.

## 35.276 euro për festimin e Ditës së Turqve

Në mbledhjen e saj të 60-të, Qeveria e Kosovës ka ndarë 35.276 euro për festimin e 23 Prillit, Ditës Kombëtare të Turqve. Këto mjete janë ndarë nga “rezervat e paparashikuara” të Qeverisë dhe janë transferuar në konton e Organizatës Joqeveritare “Multhietnic Society of Kosovo”.

Sipas Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, 23 prilli është Dita e Turqve. Por, nuk është festë zyrtare. Është Ditë Memoriale.

Ashtu siç është 28 Nëntori – Dita e Shqiptarëve, 12 Qershori – Dita e Paqes; 8 Prilli – Dita e Romëve; 15 Shkurti – Dita e Ashkalinjve; 28

Shtatori – Dita e Boshnjakëve; dhe 6 Maji – Dita e Goranëve.

Në vendim nuk theksohet asgjë edhe për rolin e Komisionit Republikan të Festave, i cili, sipas Ligjit për Festat Zyrtare, ka për detyrë që të përgatisë rregullat dhe mënyrat e festimit të festave zyrtare dhe ditëve memoriale. Komisioni Republikan i Festave është formuar me vendimin e Qeverisë nr. 06/31, të 27 gushtit 2008.

“Multhietnic Society of Kosovo” ka bërë kërkesë tek Qeveria e Kosovës që të financohet organizimi i tyre për nder të 23 Prillit. Qeveria i është përgjigjur pozitivisht kësaj kërkesë dhe më 21 prill ka derdhur 35.276 euro në konton e kësaj organizate.

Me këto mjete, OJQ “Multhietnic Society of Kosovo” ka organizuar program tetëditësh, nga 18 deri 25 prill. Manifestimet janë mbajtur në të gjitha qytetet e Kosovës ku jetojnë qytetarë të komunitetit turk, si në Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, Gjilan dhe Prishtinë. Manifestimi qendror është mbajtur më 23 prill në Prizren, ku kishte të ftuar përfaqësues nga institucionet vendase dhe nga shteti turk.

“Multhietnic Society of Kosovo” është e obliguar t’i dorëzojë një raport Qeverisë së Kosovës për mënyrën e shpenzimit të mjeteve dhe realizimin e programit. Data e raportimit nuk është e precizuar në obligimet e “Multhietnic Society of Kosovo”.

## Miratohet Udhëzimi Administrativ për Vulën Rrethore

Me vendimin 19/61, Qeveria e Kosovës miratoi Udhëzimin Administrativ për Vulën Rrethore. Ky vendim bazohet në Ligjin për Vulat e Institucioneve të Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, i cili rregullon dhe përcakton formën dhe përmbajtjen e vulës, procedurën për mënyrën e punimit, përdorimit si dhe autorizimin për përdorimin e vulës në institucionet e Republikës së Kosovës, pajisja me vulë autorizohet nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Te gjitha institucionet duhet të

kenë vetëm një vulë, me përjashtim te rasteve te veçanta kur ato mund të kenë edhe një vulë të vogël. Institucionit i lejohej të ketë më shumë ekzemplarë të vulave, nëse ushtron veprimtarinë e tij në më shumë se në një ndërtesë dhe nëse është e arsyeshme, sipas kërkesave të punës.

Me vulë vulosen vetëm ato akte, dokumente dhe shkresa, që janë nënshkruar nga personi i autorizuar. Janë tri lloje te vulave që përdoren: rrethore, katrore, si dhe vula që përdoret nga Komunitet e Kosovës - e cila përmban stemën e Komunitetit.

Vula rrethore është me diametër prej 40 milimetra, 50 milimetra, si dhe 60 milimetra, varësisht nga gjatësia e tekstit dhe numri i gjuhëve që duhet të përmbajë vula.

Vula që përdoret për protokollimin e shkresave është katrore. Ajo ka dimensionin 35 milimetra me 70 milimetra. Por, sipas nevojës, mund të ketë edhe dimensione të tjera.

Komunitet e Kosovës përdorin vulën me stemën e tyre në ato akte për të cilat nuk janë të obliguara të vendosin stemën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

# Miratohet Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011

Në mbledhjen e 12-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbajtur më 20 mars 2008, është marrë vendim që të iniciohet procedura për hartimin e një Plani Kombëtar Veprimi për Personat me Aftësi të Kufizuara, i Republikës së Kosovës, 2009-2011.

Qëllimi kryesor i tij është harmonizimi i ligjeve ndërkombëtare me ato të Kosovës, si dhe respektimi i tetë parimeve kryesore, të dala nga ky dokument: Respektimi i dinjitetit të patjetërsueshëm, autonomisë, përfshirë lirinë për të sjellë vendime individuale, dhe i pavarësisë së personave; Jo-diskriminimi; Pjesëmarrja e plotë, efikase dhe përfshirja në shoqëri; Respekti për dallimet dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara, si pjesë e diversitetit, ose larmisë njerëzore; Mundësitë e barabarta; Qasja; Barazia midis meshkujve dhe femrave; si dhe Respektimi i kapaciteteve evoluese të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetet e tyre.

Këto parime duhet plotësuara në

fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, mbrojtjes sociale.

Në fushën e shëndetësisë, Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara parasheh arritjen e këtyre pesë objektivave: 1. Kujdesi i gjithëmbarsuem, pa pagesë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara; 2. Hartimi i programit kombëtar

kombëtar.

Në fushën e arsimit parashihet të arrihen këto objektiva: 1. Krijimi i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit; 2. Implementimi i legjislacionit në fushën e arsimit për persona me aftësi të kufizuara; 3. Garantimi i sistemit arsimor gjithëpërfshirës

Me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë në shëndetësi, arsim, punësim dhe shërbime sociale, ky plan parashtron objektivat dhe aktivitetet për t'u arritur në periudhën 2009-2011

për qasjen profesionale të ofruesve të shërbimeve mjekësore ndaj personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; 3. Përmirësimi i qasjes ndaj infrastrukturës shëndetësore; 4. Përmirësimi i shërbimeve të riaftësimi për personat me aftësi të kufizuara; 5. Vënia në dispozicion të përhershëm e interpretuesit të gjuhës së shenjave në sistemin shëndetësor, në nivel lokal dhe

në institucionet parashkollore; 4. Programet e zhvillimit profesional për arsimin gjithëpërfshirës për arsimtarët dhe njerëzit e inkuadruar në sistemin arsimor; 5. Përmirësimi i kompetencave për aftësitë e kufizuara në nivel komunal.

Për këto dhe objektivat tjera që parashihen të arrihen në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, mjetet financiare janë të parapara me KASH 2009-2011.

## 4.150 euro për shënimin e 10 vjetorit të masakrës serbe në Burgun e Dubravës

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 30 prill 2009, mori vendim që të ndajë 4.150 euro për shënimin e 10 vjetorit të masakrës serbe në Burgun e Dubravës. Akademia Përkujtimore për këtë

rast do të mbahet më 22 maj 2009. Mjetet e ndara do t'i transferohen Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, e cila është përgjegjëse për organizimin e Akademisë Përkujtimore. Ajo do të organizohet në Prishtinë dhe

në Burgun e Dubravës.

Mes datave 19 dhe 24 maj, të viti 1999, në Burgun e Dubravës, u vranë rreth 170 të burgosur, ndërsa 200 të tjerë u plagosën.

## Qeveria ndau 4.265 € për shënimin e 27 prillit – Ditës së të Pagjeturve në Kosovë

Në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2009, Qeveria e Kosovës ka ndarë 4.265 euro për shënimin e 27 Prillit – Ditës së të Pagjeturve në Kosovë. Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur, në bashkëpunim me Shoqatat e Familjarëve të Personave të Pagjetur dhe organizatat ndërkombëtare që janë të involvuara në procesin e çështjes së personave të pagjetur, kishin organizuar një sërë aktivitetesh në shënimin e kësaj dite.

Aktivitetet kryesore, të organizuara nga ky Komision,

ishin: Një ekspozitë me fotografi, në Teatrin Kombëtar, mbajtur nga 24 deri më 27 Prill; organizimi dhe mbajtja e një tryeze të rrumbullakët me 25 prill, në ndërtesën e Qeverisë, me temën “Pas 10 vjetësh, fati i personave të pagjetur duhet të ndriçohet”; organizimi i vizitave në familjet e të pagjeturve, vizita në varrezat dhe memorialet nga shoqatat, në bashkëpunim me autoritetet lokale, si dhe një Akademi Përkujtimore në Mejë të Gjakovës.

Mjetet e ndara nga Qeveria mbulojnë shpenzimet e ekspozitës (letër, mbajtëse për fotografi, pagesat për personat

kujdestarë, plastifikim fotografish etj), shpenzimetet tryezës (ushqim, pije), shpenzimet e akademisë përkujtimore (vendosja e foltores/binës, zërimi, materiale të ndryshme për zyrë, kopjim, udhëtim, pano për ekspozitë të fotove e mbishkrimeve), vizitat (shpenzime për kurorë, pllakat me mbishkrime, bluza, udhëtime për anëtarët e Këshillit Organizativ, komunikim telefoni) etj. Këto mjete pritet të derdhen në kontot e organizatave/ shoqatave të përfshira në javën e tretë të këtij muaji.

Dhjetë vjet pas përfundimit të luftës, ende nuk dihet fati i 1907 personave të pagjetur.

## Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ushqim, kërkohet ndryshimi i Udhëzimit Administrativ 18/2005

Pas një kohe të gjatë shqyrtimesh, Ligji për Ushqimin është miratuar në Kuvendin e Kosovës, në shkurt të këtij viti. Sipas këtij ligji, Agjencioni Veterinar dhe

i Ushqimit, i cili ishte pjesë e Ministrisë së Bujqësisë, ka kaluar si agjencion në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Pas miratimit të Ligjit për Ushqim, është parë i nevojshëm edhe ndryshimi i

akteve nënligjore dhe përshtatja e tyre me ligjin. Vendimi nuk parasheh afat kohor se kur pritet të bëhet ndryshimi i kësaj urdhërese administrative.

## Miratohet Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit për këtë strategji

Më 8 prill 2009, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Planin e Veprimit për këtë strategji.

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Agjencionin Veterinar dhe të Ushqimit, është e obliguar ta zbatojë atë.

Sipas strategjisë, Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK), nënkupton bashkërendim dhe bashkëpunim

deri më 31 dhjetor 1988. Kufiri me Republikën e Shqipërisë është pjesërisht i shënuar, ndërsa ai me Republikën e Maqedonisë është në finalizim e sipër. Kufiri me Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë pritet të shënjohej në të ardhmen.

Sipërfaqja e Republikës së Kosovës është 10.908 km<sup>2</sup>, me gjatësi të kufirit shtetëror si vijon: Shqipëria - 113.551 km, Maqedonia - 170.772 km, Mali i Zi - 79.165 km dhe Serbia - 380.068 km. Gati të gjithë kufijtë e vendit janë ruralë dhe malorë.

Aktualisht në Kosovë

Aktualisht, KFOR-i vazhdon të jetë ende përgjegjës për Kufirin e Gjellbër dhe Kufirin e Kaltër (ujërat). Agjencitë kryesore të Republikës së Kosovës të përfshira në MIK janë: Policia e Kosovës – MPB, Doganat e Kosovës - MEF dhe Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës - AVUK. Menaxhimi i Integruar dhe Kontrolli i Kufirit Shtetëror është kryesisht kompetencë e MPB-së. Në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon Policia Kufitare (PK), e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin në PKK. Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. AVUK është përgjegjës për sigurinë e shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe bimëve, si dhe sigurinë e produkteve me origjinë bimore.

Strategjia përcakton disa objektiva që duhet të arrihen, kurse Plani i Veprimit jep një pasqyrë më të qartë se si dhe kur do të arrihen ato: harmonizimi i Rregullores së Brendshme të Policisë së Kosovës me legjisllacionin në fuqi (nëntor 2009); strukturimi organizativ për Policinë Kufitare (nëntor 2009); transferimi i përgjegjëseve nga KFOR-i për kontrollin e vijës së Gjellbër dhe asaj të Kaltër (qershor 2011); avancimi i bashkëpunimit mes departamenteve në kuadër të Policisë së Kosovës (nëntor 2009); sigurimi i pajisjeve të nevojshme për Policinë Kufitare (maj 2011); arritja e standardeve evropiane në fushën e legjisllacionit (qershor 2010); etj.

Realizimi i të gjitha objektivave do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës me rreth 27 milionë euro, për periudhën maj 2009 – qershor 2012.

Strategjia identifikon 57 objektiva që duhet përmbushur deri në qershor 2012. Për realizimin e këtyre objektivave nevojiten rreth 27 milionë euro, pa përfshirë kostot administrative.

kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, si dhe vendosjen e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të integruar të kufirit, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përbashkët i kufijve të hapur, por të kontrolluar mirë dhe të sigurt.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për MIK-un ndjek udhëzimet e MIK-ut të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe përqendrohet tek tri agjencitë kryesore që kanë përgjegjësi në kufi: Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, si dhe i referohet një sërë agjencive të tjera dhe operatorëve që janë aktivë në fushën e menaxhimit të kufirit.

Territori i Republikës së Kosovës është përcaktuar me Pakon e Ahtisaarit, në vijat kufitare

funksionojnë 13 pikëkalime kufitare dhe dy pikëkalime kufitare të përkohshme në Krushevë dhe Orqushë, të cilat janë nën mbikëqyrjen e pikëkalimit kufitar të Vërmicës. Pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë janë Vërmica, Qafa e Prushit dhe Qafa e Morinës; me Republikën e Malit të Zi është Kulla; me Republikën e Serbisë janë Bërnjak, Jarinje, Merdare, Mutivodë, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë; me Republikën e Maqedonisë janë Hani i Elezit dhe Gllboçica.

Pika e kalimit kufitar të trafikut hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë është Hani i Elezit, ndërsa me Republikën e Serbisë janë Leshaku dhe Merdare (jashtë funksionit). Pikëkalimi kufitar i trafikut ajror është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.



## Qartësohen obligimet e KEK-ut ndaj Administratës Tatimore

28

Në prag të privatizimit të KEK-ut, Qeveria e Kosovës dëshiron të eliminojë të gjitha paqartësitë lidhur me obligimet financiare të KEK-ut. Për këtë qëllim, Qeveria, me një vendim - 02/60, i ka dhënë mbështetje vendimit shpjegues të MEF për detyrimet tatimore të KEK-ut, me rastin e importit të energjisë elektrike.

KEK-u ka qenë i obliguar ta bëjë pagesën e TVSH-së për rrymën e importuar. Mirëpo, nuk e ka bërë një gjë të tillë, duke u mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit mes AKM-së, MEF-it dhe ATK-së. Një vendim i tillë është marrë pas kërkesës së Doganave të Kosovës, sipas së cilës, KEK-u nuk është duke paguar për rrymën e importuar.

Sipas vendimit 02/60, KEK-u

nuk do të ketë obligime që të paguajë TVSH për rrymën e importuar, por vetëm të shlyejë detyrimet tatimore të deritashme që ka në ATK. KEK-u do të paguajë TVSH për energjinë e brendshme në shkallën prej 16%, sipas Ligjit të ri për TVSH-në. Ky vendim do të pushojë së zbatuari ditën kur do të privatizohet divizioni i shpërndarjes dhe furnizimit.

## Nuk janë arritur në tërësi objektivat e deritashme të Strategjisë së Energjisë 2005-2015

Qeveria e Kosovës, me vendimin 20/61, ka miratuar Raportin e Progresit për programin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2006-2008.

Në tetor të vitit 2005, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë 2005-2015. Strategjia ndan objektivat në ato që duhet të arrihen brenda një afati kohor

prej tre vjetësh, pra deri në vitin 2008, si dhe në ato që duhet të zbatohen deri në vitin 2015.

Me Ligjin për Energjinë, MEM është i obliguar që të përgatisë Programin e zbatimit të Strategjisë, në një hark kohor së paku trevjeçar. Po ashtu, Ligji për Energjinë parasheh që MEM, si autoritet kompetent, të propozojë ndryshimet në Strategjinë e

Energjisë, në një periudhë prej tre vjetësh, gjë që MEM nuk e ka bërë ende.

Sipas Strategjisë, objektivat për periudhën 2005-2015 janë: 1. Brenda kësaj periudhe, të ketë kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike prej së paku rreth 1800 MW; 2. Të reformohet KEK-u, duke siguruar arkëtim të plotë të energjisë elektrike të faturuar deri

më 2009; 3. Të modernizohet rrjeti i bartjes dhe shpërndarjes, duke siguruar integrimin e tyre me rrjetin rajonal dhe evropian të energjisë, dhe duke reduktuar humbjet teknike në nivel të standardeve ndërkombëtare deri me 2010-2012; 4. Të rritet pjesëmarrja e sektorit privat, në të paktën 60 % në financimin e investimeve të gjithëmbarshme të këtij sektori; 5. Deri në fund të vitit 2012, qendrat rajonale të Kosovës të bëhen me sistem të ngrohjes qendrore dhe Kosova të lidhet me gazsjellës rajonal; 6. Deri në vitin 2010, të sanohen pasojat në mjedis të Termocentraleve ekzistuese të KEK-ut; 7. Të rritet vetëdija e qytetarëve për përdorimin racional të energjisë; 8. Të krijohen kapacitetet për hulumtim dhe zhvillim, etj.

Sa i përket periudhës 2006-2008, objektivat që do të duhej të arriheshin janë: Sigurimi i furnizimit të mjaftueshëm me linjit nga minierat për termocentralet ekzistuese; fillimi i menjëhershëm i përgatitjeve për hapjen e minierës së re në fushën e Sibovcit; përgatitja e Planit Veprues për rikultivimin e zonave

të shteruara të qymyrit; lidhja e marrëveshjeve me sistemet fqinje për shkëmbim të energjisë elektrike; inicimi i përgatitjeve për ndërtimin e kapaciteteve ndërlidhëse prej 400 kilovoltësh me sistemin elektrik të Shqipërisë; përmirësimi i menaxhmentit dhe i pasjes së termocentraleve ekzistuese, përmes procedurave të rregullta të mirëmbajtjes; revitalizimi i TC Kosova A,

Sipas këtij raporti, Ministria e Energjisë dhe Minierave ka bërë disa veprime që prekin secilin prej objektivave të lartpërmendura. Megjithatë, asnjëra nuk është e përfunduar

gjatë vitit 2006; përgatitja e dokumentacionit për tërheqjen e investitorit për termocentralin e ri; përgatitja e dokumentacionit për tender për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit Zhur; shpallja e ofertës për revitalizim të hidrocentraleve të vogla; po ashtu thuhet se në fillim të vitit 2008, ose më së largu në 2009, Qeveria do të synojë që të koncesionojë, ose edhe privatizojë plotësisht a pjesërisht, Minierat, TC Kosova A, TC Kosova B dhe Furnizimin. Sa janë arritur këto objektiva?

Për këtë, MEM ka paraqitur

Raportin e Progresit, lidhur me programin për zbatimin e Strategjisë Energjetike të Kosovës, për periudhën 2006-2008. Sipas këtij raporti, Ministria e Energjisë dhe Minierave ka bërë disa veprime që prekin secilin prej objektivave të lartpërmendura. Megjithatë, asnjëra nuk është e përfunduar.

Është aktivizuar sektori i Sitnicës; janë bërë punët përgatitore për hapjen e Minierës së Sibovcit jugperëndimor; janë riparuar Blloqet e vjetra të TC Kosova A, por nuk është siguruar pasja e plotë e tyre; është investuar në kapacitetet e rrjetit,

por linja 400 kilovoltëshe me Shqipërinë ka mbetur vetëm si marrëveshje në letër; projektligjet për ngrohjen qendrore dhe gazin natyror nuk janë hartuar, por MEM thotë se pritet të hartohen së shpejti; është hartuar legjislacioni për efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtërishme, e në nën tjetër MEM nuk ka përgatitur ende pakon tenderuese për hidrocentralet e vogla - për të cilën thotë se është në fazën përfundimtare.



Kaçikoll  
Kecikol

Prishtinë  
Pristina

## Formohet Grupi Punues për Hartimin e Dokumentit Përmbajtjesor të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave

Me vendimin nr. 07/60, Qeveria e Kosovës formoi Grupin Punues për Hartimin e Dokumentit Përmbajtjesor të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave.

Në përbërje të tij janë caktuar përfaqësues nga Ministritë, Komunat, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Republikës së Kosovës, Agjencioni i Arkivave, Instituti Albanologjik, Agjencioni Kadastral dhe Instituti i

Historisë.

Kryesuese e këtij Grupi Punues është caktuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). MAPL ka hartuar planin e veprimit për takimet me përfaqësuesit e secilit institucion, të caktuar me vendimin e Qeverisë. Sipas MAPL, pas takimeve individuale me secilin institucion, që kryesohen nga Zëvendësministri i MAPL, do të organizohet një këshillim i përbashkët, me qëllim të finalizimit të Dokumentit Përmbajtjesor

të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave. Afati për dorëzimin e këtij projektligji në Qeverinë e Republikës së Kosovës është fundi i vitit 2009.

Ky ligj parashihet të vërë rregull në emërtimet zyrtare të vendbanimeve në Kosovë. Pas luftës, më 1999, shumë vendbanime mbajnë emra të ndryshëm nga ata që kishin para luftës. Këto emërtime të reja shpesh nuk janë pranuar zyrtarisht, as nga Komunat dhe as nga Administrata Ndërkombëtare në Kosovë.

## Inicohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit

Në mbledhjen e 62-të të Qeverisë së Kosovës është marrë vendimi 03/62, për iniciimin e procedurës për hartimin e Strategjisë Nacionale Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit. Hartimin e kësaj strategjie do ta bëjë Agjencioni për Barazi Gjinore (ABGJ), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Nuk është dhënë ndonjë afat kohor se brenda çfarë periudhe do të

hartohet kjo strategji. Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, i publikuar në nëntor 2008, kritikohet Qeveria e Kosovës për mosnxjerrjen e një strategjie për mbrojtjen e femrave, si dhe vihen në pah mungesat e kapaciteteve të Agjencionit për Barazi Gjinore.

Strategjia vështirë se do të mund të përfundohej para publikimit të Raportit të Progresit për vitin 2009.

Sipas zyrtarëve të ABGJ, strategjia do të shërbejë si udhëzues nacional për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, për parandalimin, sigurinë, drejtësinë dhe trajtimin e viktimave dhe abuzuesve të dhunës në familje. Po ashtu, do të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare.

Në mënyrë që kjo strategji të jetë sa më gjithëpërfshirëse, ABGJ, në

bashkëpunim me konsulentët e saj, ka identifikuar tri shtylla kryesore, në bazë të të cilave do të përpilohet strategjia. Gjithashtu, ka arritur të përcaktojë përfaqësuesit e grupeve punuese, në bashkëpunim me të cilët synon të realizojë këtë proces.

Tri shtyllat e identifikuar deri më tash, të cilat konsiderohen se do të ndërtohen në bashkëpunim me grupet punuese, janë: parandalimi, mbrojtja dhe siguria, si dhe përkrahja e trajtimit.

Më 27 maj, do të mbahet takimi

i parë i organizuar nga ABGJ, me të gjithë bashkëpunëtorët që konsiderohet të jenë pjesë aktive e këtij procesi. Do të prezantohet edhe kalendari i aktiviteteve, sipas të cilit synohet të përpilohet strategjia.

## Zbatimi i vendimeve të janarit

Në janar të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka marrë 18 vendime. Në këtë numër, do të raportojmë për

pesë nga këto vendime, zbatimin e të cilave ka ngecur deri më tash, ose që janë në proces për t'u realizuar

tërësisht. Për vendimet tjera, shihni numrat e kaluar të GAP Monitor.

### Vendimi 03/49 për lejimin e Zyrës së Komuniteteve të punësojë personel shtesë

Me vendimin nr. 03/49, Qeveria e Kosovës, më 9 janar 2009, i ka lejuar Zyrës për Komunitete pranë Kryeministrit (ZKK) që të rekrutojë staf, konform organogramit të paraqitur nga kjo zyrë. Sipas organogramit, ZKK do të ketë gjashtë të punësuar, 3 që tashmë

janë në punë, ndërsa Qeveria ka lejuar edhe pranimin e 3 të tjerëve që do të punojnë si: zyrtar për politika, zyrtar për financa dhe grante, zyrtar për informim dhe terren. ZKK ka shpallur konkursin dhe për këto pozita kanë konkurruar gjithsej 28 veta: 15 kandidatura

për postin e zyrtarit për politika, 7 kandidatura për zyrtar për financa dhe grante, 6 kandidatë për postin e zyrtarit për informim dhe terren. Intervistimi i tyre pritet të bëhet së shpejti. Ky vendim po i afrohet fazës përfundimtare të zbatimit.



### Vendimi 06/51 për renovimin e shtëpive të dëmtuara në lagjen Kroi i Vitakut në Mitrovicë

Me vendimin 06/51, Qeveria e Kosovës, më 23 janar 2009, ka ndarë 100.000 euro për renovimin e shtëpive në lagjen Kroi i Vitakut, në

Mitrovicë. Renovimi i pesë shtëpive në këtë lagje filloi në prill të këtij viti. Punimet janë duke vazhduar.

### Vendimi 07/51 për renovimin e tërësishëm të shtëpisë së dëshmorit të kombit Hasan Ramadani

Po më 23 janar 2009, Qeveria e Kosovës mori vendimin 07/51 për ndarjen e 20.000 eurove për renovimin e shtëpisë së dëshmorit Hasan Ramadani, nga Komuna e Podujevës. Implementim

i këtij vendimi është duke u bërë nga Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Dega në Podujevë. Punimet për renovimin e shtëpisë kanë filluar që në mars të këtij viti dhe ende janë duke vazhduar.

### Vendimi 03/52 për themelimin e Komisionit për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve të Tjera të Veçanta

Komisioni për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe grupeve tjera të veçanta, i cili është themeluar në janar të këtij viti, me

vendimin 03/52, ka për detyrë që deri më 20 maj 2009 të shqyrtojë projektet konkurruese, ndërsa pas 20 majit të bëjë publik fituesit e këtyre fondeve. Deri më 20 prill

2009, kur është mbyllur konkursi publik për fonde, kanë aplikuar 53 organizata mediale.

## Zbatimi i vendimeve të shkurtit

Në shkurt janë marrë 13 vendime. Në këtë numër, do të raportojmë për ato vendime, zbatimi i të cilave shtrihet edhe në muajin prill.

Vendimi 02/54 për miratimin e propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme që në Strategjinë Legjislative 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet edhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik nr.2003/17



Qeveria e Kosovës, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me vendimin 02/54, vendosi që në strategjinë legjislative për këtë vit të përfshijë edhe Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Sipas MPJ-së, ndryshimi i këtij ligji është tepër i domosdoshëm, për shkak se në formën aktuale Ligji për Prokurimin

Publik i pamundëson MPJ-së të bëjë blerje jashtë vendit, siç janë Ambasadat. Sipas zyrtarëve të Qeverisë, kanë filluar procedurat për ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik dhe pritet që këto ndryshime të miratohen në Qeveri gjatë muajit maj.

Vendimi 02/55 për ndarjen e 150.000 € për organizimin e kremtimeve lidhur me njëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Me rastin e kremtimit të njëvjetorit të pavarësisë së vendit, Qeveria e Kosovës, me vendimin 02/55, ka ndarë 150.000 euro për organizimin e kremtes

së 17 shkurtit 2009. Qeveria nuk ka publikuar ndonjë raport për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve. Raporti i shpenzimeve do të përfshihet në kuadër të Raportit për Shpenzimet e Tremujorit të

parë të Buxhetit të Kosovës, për 2009. Sipas raportit të shpenzimeve të buxhetit për tre mujorin e parë të 2009, nuk jepet ndonjë raport i detajuar se si janë shpenzuar këto mjete.

Vendimi 03/56 për miratimin e kërkesës së Komisionit Qeveritar për Demarkacion të Kufirit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 279.276 €, për vazhdimin e punëve në 2009

Vendimi 03/56 për ndarjen e 279.276 eurove për demarkacion të kufirit dhe vazhdim të punës

për këtë çështje, është ende në proces të zbatimit. Komisioni Qeveritar për Demarkacion të Kufirit Kosovë-Maqedoni ende

nuk ka përfunduar punën e tij. Për mbarëvajtjen e tërë këtij procesi do të raportojmë kur të mbyllet puna rreth demarkacionit.

Vendimi 04/56 për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e qirasë për familjet e zhvendosura nga pronat e tyre në veriun e Mitrovicës

Vendimi 04/56. Në shkurt të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka ndarë 360.000 euro për pagesën e qirasë, për 300 të zhvendosur nga veriu

i Mitrovicës. Në konkursin e hapur nga Komuna e Mitrovicës, kanë aplikuar mbi 460 familje, por vetëm 300 prej tyre mund të përfitojnë.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës ende nuk ka bërë përzgjedhjen e këtyre familjeve përfituese. Kjo pritet të bëhet vetëm në fillim të qershorit.

## Zbatimi i vendimeve të marsit

Në muajin mars, Qeveria e Kosovës kamarrë 19 vendime.

Për këto vendime, kemi shkruar në numrin e tretë të GAP Monitor. Këtu do të shqyrtojmë shtatë

vendime, procesi i implementimit të të cilave shtrihet edhe në muajin prill.



**Vendimi 02/57 për shpalljen Zonë e Interesit të Veçantë Ekonomik "Fushën e Mihjes së Re" me një sipërfaqe prej 143,254 km<sup>2</sup>**

Me vendimin 02/57, Qeveria e Kosovës shpalli zonë të interesit të veçantë ekonomik Fushën e Mihjes së Re. Kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej 143.254 km<sup>2</sup>. Plani Hapësinor për këtë zonë ende nuk ka filluar të hartohet. Sipas Institutit për

Planifikim Hapësinor, është formuar grupi punues për këtë çështje dhe pritet që ky plan të hartohet në procedurë të përsheptuar dhe t'i dërgohet Qeverisë për miratim në muajin nëntor, eventualisht në dhjetor 2009.

**Vendimi 03/57 për hartimin e planit hapësinor për Zonën e Veçantë Parku Nacional "Mali Sharr"**

Me vendimin 03/57, Qeveria e Kosovës kërkoi nga MAPH hartimin e planit hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr". Instituti për Planifikim Hapësinor, në kuadër

të MAPH, ka përgatitur një draft të këtij plani. Ky draft-plan është publikuar edhe në faqen zyrtare të MAPH [http://www.ks-gov.net/mmph/document/shqip/PNMSH\\_Plani\\_%20Hapësinor\\_%20260209\\_final.pdf](http://www.ks-gov.net/mmph/document/shqip/PNMSH_Plani_%20Hapësinor_%20260209_final.pdf).

Plani pritet të hidhet në diskutim publik, ku do të qëndrojë 60 ditë. Diku në muajin shtator, pritet t'i dërgohet Qeverisë për miratim.

**Vendimi 04/57, me të cilin "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulët të Komunës së Lipjanit vihet në mbrojtje nën kategorinë e monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë**

Me vendimin 04/57, të 13 marsit 2009, Qeveria vendosi që Shpella e Gadimes të vihet nën përkujdesje institucionale. Me implementimin e

këtij vendimi ngarkohej MAPH. Deri më tash, në këtë drejtim, nuk është ndërmarrë asgjë konkrete. Edhe më tutje shpella menaxhohet nga Nazif

Tasholli. Vizitorët në këtë shpellë duhet të paguajnë 2.5 euro për të hyrë në shpellë.

**Vendimi 06/57 për Themelimin e Komisionit Qeveritar për Çështje Fiskale dhe Buxhetore**

Në mbledhjen e 57-të të Qeverisë, me vendimin 06/57, Qeveria e Kosovës ka themeluar Komisionin Qeveritar për Çështje Fiskale dhe Buxhetore, me qëllim që të ndihmohet zbatimi i politikave fiskale, përfshirë zhvillimin vjetor të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Komisioni përbëhet nga Kryeministri i Kosovës, i cili njëherësh është

edhe Kryesues i Komisionit, Ministri i MEF-it, Ministri i MASHT-it, Ministri i MSH-së, Ministri i MPMS-së, Ministri i MTPT-së, si dhe Ministri i MTI-së. Detyrë e këtij komisioni është dhënia e rekomandimeve për Qeverinë lidhur me politikat fiskale. Që nga themelimi i Komisionit Qeveritar për Çështje Fiskale dhe Buxhetore, më 13 mars 2009, e deri më 13 prill 2009, ky komision është

takuar vetëm një herë me grupin punues. Aty, ishte i pranishëm edhe një profesor nga Sllovenia, Mojmir Mrak (si ekspert i dërguar nga DFID-i), i cili ka premtuar se do të ofrojë rekomandime më të plota për punën e komisioneve dhe rekomandimeve që ky grup duhet t'ia japë Qeverisë. Takimi i radhës do të mbahet brenda muajit qershor, në afat prej 10-15 ditësh.

**Vendimi 09/57 për Themelimin e Këshillit Ekonomiko-Social (KES)**

Në takim me Odën Ekonomike është thënë se gjatë muajit maj pritet të mbahet një takim. Ky takim nuk është realizuar ende. Gjithashtu, nuk është ndërmarrë ndonjë vendim konkret, sepse, pas konkursit në

të cilin këta anëtarë kanë aplikuar për KES, nuk ka arritur ndonjë përgjigje nga MPMS, se kush-kënd do ta përfaqësojë më shumë nga punëdhënësit. Si rezultat i mungesës së kësaj përgjigjeje, përderisa nuk

bëhet definimi konkret se kush do ta përfaqësojë shumicën, nuk mund të realizohet asnjë nga funksionet e Këshillit. Siç duket, KES do ta ketë fatin e paraardhësit të tij, Këshillit Konsultativ Trepalësh.

## Vendimi 10/57 për përkrahjen e Projektit Shumetrik në Komunën e Novobërdës

Në mars, me vendimin 10/57, Qeveria e Kosovës ka përkrahur Projektin Shumetrik për Komunën e Novobërdës, i cili, 29 familjeve u ofron zgjidhje të qëndrueshme, me ndërhyrje sociale dhe ekonomike.

Për implementimin e këtij projekti është ngarkuar Zyra për Komunitete pranë Kryeministrit. Tash për tash, projekti ndodhet në fazën fillestare, të procedimit të tenderit, e cila nuk ka ndonjë afat të caktuar për

përfundim. Sapo të përfundojë procesi i tenderimit, do të fillojë puna për ndërtimin e shtëpive. As kjo nuk ka ndonjë afat të përcaktuar për përfundim të projektit.

## Vendimi 03/59, me të cilin do të fillojë shpronësimi i pronave të paluajtshme për nevoja të ndërtimit të Autostradës Vërmicë-Merdarë, segmenti Vërmicë-Prizren

Në mars, Qeveria ka marrë vendimin 03/59, me të cilin do të fillojë shpronësimi i pronave të paluajtshme për nevoja të ndërtimit të Autostradës Vërmicë-Merdarë, segmenti Vërmicë-Prizren. Ministria

e Transportit dhe Telekomunikacionit ka përgatitur elaboratin që identifikon pronat të cilat duhet të shpronësohen, përfshirë këtu madhësinë, pozitën dhe pronarin e secilës prej këtyre pronave. Ministria

e Ekonomisë dhe Financave, me Ligjin për Shpronësim, është ngarkuar me punën e kompensimit të qytetarëve të cilëve do t'u merren pronat. Megjithatë, kjo Ministri ende nuk ka bërë diçka në këtë drejtim.

## Vendimi 06/59 me të cilin miratohet Projektligji për anëtarësim në FMN dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore

Në mars, Qeveria e Kosovës kishte miratuar Projektligjin për Anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore (vendimi 06/59). Edhe pse në vendim thuhej se projektligji i miratuar duhej t'i dërgohej Kuvendit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, deri më 15 maj 2009. Kjo vonesë, nga data e miratimit deri tek dërgimi në Kuvend, është arsyetuar me

faktin se Qeveria është duke i bërë edhe disa ndryshime në tekst. Ky projektligj është i shkurtër, ka 10 nene gjithsej. Në të thuhet se Qeveria e Kosovës është e autorizuar, në emër të Republikës së Kosovës, për anëtarësimin në FMN, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim,

në Agjencinë për Garantimin e Investimeve Multilaterale, si dhe në Qendrën Ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera (IKSID). Brenda gjashtë muajve, nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes së anëtarësisë në FMN dhe BB, Kosova duhet të deponojë 154 milionë euro.

Për të lexuar të gjithë numrat e GAP Monitorit bashkë me publikimet e tjera të Institutit GAP, na vizitoni në faqen tonë të internetit:

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)



PËRMBLEDHJE

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Në muajin prill të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta: mbledhjet 60, 61 dhe 62. Më poshtë mund t'i gjeni 44 vendimet e prillit, në formë kronologjike dhe ashtu siç janë publikuar:

**1. Vendimet nga mbledhja e 60-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 8 prill 2009:**

- 1.1. Vendimi 02/60, me të cilin i jepet mbështetje Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të nxjerrë vendim shpjegues, për të qartësuar obligimet e TVSH-së për KEK-un, lidhur me importet e energjisë elektrike dhe furnizimin vendor të energjisë elektrike;
- 1.2. Vendimi 03/60, me të cilin emërohen anëtarët e Komisionit për Përdorimin e Gjuhëve;
- 1.3. Vendimi 04/60, ndahen mjete financiare në vlerë prej 35.276 euro për organizimin e kremtimeve me rastin e Festës së 23 Prillit, Ditës së Turqve;
- 1.4. Vendimi 05/60, me të cilin vendoset që listës së personave që do të pajisen me pasaportë diplomatike i shtohet edhe Shefi i Agjencisë së Inteligjencës;
- 1.5. Vendimi 06/60, me të cilin i kërkohet MPB-së që të iniciojë procedurat për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit;
- 1.6. Vendimi 07/60, me të cilin formohet Grupi Punues për Hartimin e Dokumentit Përmbajtësor të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave të Republikës së Kosovës;
- 1.7. Vendimi 08/60, miratohet Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit për këtë strategji;
- 1.8. Vendimi 09/60, miratohet Projektligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë;

**2. Vendimet nga mbledhja e 61-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 23 prill 2009:**

- 2.1. Vendimi 02/61, miratohet kërkesa e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të organizojë mbajtjen e bursës së punësimit "Bursa e Punësimit Kosova 2009", në bashkëpunim me Aleancën Kosovare të Bizneseve. Për organizimin e këtij panairi ndahen 36.830 euro;
- 2.2. Vendimi 03/61, në Strategjinë Legjislative 2009, të përfshihet edhe Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës;
- 2.3. Vendimi 04/61, ndahen mjete financiare në vlerë prej 4.265 euro për shënimin e 27 Prillit – Ditës së të Pagjeturve në Kosovë;
- 2.4. Vendimi 05/61, për ndryshimin e vendimit 03/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës;
- 2.5. Vendimi 06/61, për ndryshimin e vendimit 04/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Kompanisë së Ujitjes "Drini i Bardhë";
- 2.6. Vendimi 07/61, për ndryshimin e vendimit 05/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Hekurudhave të Kosovës;
- 2.7. Vendimi 08/61, për ndryshimin e vendimit 06/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike "Hidrosistemi Ibër-Lepenc";
- 2.8. Vendimi 09/61, për ndryshimin e vendimit 11/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Kompanisë së Ujitjes Radoniqi – Dukagjin;
- 2.9. Vendimi 10/61, për ndryshimin e vendimit 12/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujitjes "Hidrodrini" - Pejë;
- 2.10. Vendimi 11/61, për ndryshimin e vendimit 14/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujitjes "Hidroregjioni Jugor" - Prizren;
- 2.11. Vendimi 12/61, për ndryshimin e vendimit 17/48 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujitjes "Radoniqi" – Gjakovë;
- 2.12. Vendimi 13/61, miratohet Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë;
- 2.13. Vendimi 14/61, miratohet me ndryshime Projektligji për Pagat e Nëpunësve Civilë;
- 2.14. Vendimi 15/61, miratohet me ndryshime Projektligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- 2.15. Vendimi 16/61, miratohet Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë;

- 2.16. Vendimi 17/61, miratohet Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;
- 2.17. Vendimi 18/61, miratohet Projektligji për Qytetin e Prishtinës;
- 2.18. Vendimi 19/61, miratohet Udhëzimi Administrativ për Vulën Rrethore;
- 2.19. Vendimi 20/61, miratohet Raporti i Progresit lidhur me programin për zbatimin e Strategjisë Energjetike të Kosovës për periudhën 2006 – 2008;
- 2.20. Vendimi 21/61, miratohet Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm;
- 2.21. Vendimi 22/61, familjes Foniqi nga fshati Karaqevë e Poshtme në Komunën e Kamenicës, në shenjë solidarizimi me rastin e vdekjes tragjike të djalit të tyre Erion Foniqi, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete financiare në vlerë prej 7.000 euro;
- 2.22. Vendimi 23/61, Qeveria e Republikës së Kosovës i jep mbështetje Përfundimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03-P-098/k, të datës 21 prill 2009, dhe Rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës;
- 2.23. Vendimi 24/61, miratohet Strategjia Kundër Korrupsionit 2009-2011;
- 2.24. Vendimi 25/61, miratohet Projektligji Kundër Korrupsionit;
- 2.25. Vendimi 26/61, miratohet me ndryshime Projektligji për Qeverinë;
- 2.26. Vendimi 27/61, për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Qeverisë;

### 3. Vendimet nga mbledhja e 62-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 29 prill 2009:

- 3.1. Vendimi 02/62, miratohet Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011;
- 3.2. Vendimi 03/62, inicohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit;
- 3.3. Vendimi 04/62, ndahen mjete financiare në vlerë prej 30.000 euro për ngritjen e shtatores së dëshmorit Gjeneral Adrian Krasniqi në Pejë;
- 3.4. Vendimi 05/62, miratohet ndarja e buxhetit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në shumën e kërkuar nga Agjencia dhe të miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- 3.5. Vendimi 06/62, miratohet kërkesa e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë që të bëhet amendamenti i Udhëzimit Administrativ 18/2005, konform Ligjit nr. 03/L-016 për Ushqimin;
- 3.6. Vendimi 07/62, miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012;
- 3.7. Vendimi 08/62, ndahen mjete financiare në vlerë prej 4.150 euro, me qëllim shënimin e 10 vjetorit të masakrës serbe në Burgun e Dubravës;
- 3.8. Vendimi 09/62, ndahen mjete financiare në vlerë 39.736 euro, për organizimin e festivalit muzikor ndërkombëtar të titulluar “Festivali i Lirisë” (Freedom Festival), i cili do të mbahet me datën 12 dhe 13 qershor 2009;
- 3.9. Vendimi 10/62, ndahen mjete financiare në vlerë prej 120.000 euro, për blerjen emergjente të terapisë kundër epidemisë së Gripit të Derrave - “Tamiflu”;
- 3.10. Vendimi 11/62, miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



GAP Monitor është publikim i përmuajshëm i Institutit për Studime të Avancuara GAP.

Ky numër është përgatitur nga:

Agron Demi, agron@institutigap.org; Rudina Heroi, rudina@institutigap.org;  
Shemsedin Aliu, shemsedin@institutigap.org; Florina Hajdini, florina@institutigap.org  
dhe Kreshnik Berisha, keka@institutigap.org.

Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145  
monitor@institutigap.org | www.institutigap.org